

MANUAL DIDAKTIK PËR PARANDALIMIN E DHUNËS

PRISHTINË, 2014

Redaktorët:

Merita Jonuzi, Koordinatore për të drejtat e njeriut, MASHT
Shqipe Gashi-Ramadani, Zyrtare e planprogrameve, MASHT

Autorët:

Aliriza Arenliu, Profesor në katedrën e psikologjisë, Universiteti i Prishtinës
Qëndresa Ibra-Zariqi, Zyrtare e lartë për të drejtat e fëmijëve, ZKM/ZQM
Edi Puka, Mësimdhënëse, Shkolla Filllore “Zekeria Rexha”, Gjakovë
Sheribane Bahtiri, Mësimdhënëse, Shkolla 9 Vjeçare “Faik Konica”, Prishtinë

Mbështetur nga:

Save the Children
Programi i Implementimit dhe Programi për Zhvillim dhe Kualitet
Rudina Ademi Shala
Valid Zhubi

Korrektimi:

Hazbije Qeriqi

Dizajni, faqosja dhe shtypi:

Envion

Botuar nga:

Save the Children
Gazmend Zajmi, nr. 01
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 23 26 91
Fax: +381 (0) 38 23 26 93
scik@savethechildren.org
<http://kosovo.savethechildren.net>

Copyright © 2014, Save the Children

Te gjitha të drejtat i përkasin Save the Children në Kosovë. Ai mund të riprodhohet me çdo metodë, pa pagesë apo leje paraprake për qëllime mësimore, por jo për rishitje. Për përdorimin në çfarëdo rrethane tjetër, leje paraprake me shkrim duhet të merret nga botuesi. Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë mendimet e Save the Children

ISBN 978-9951-534-26-0

Përmbajtja

Hyrje.....	4
Klasa parafillore / Barazia dhe mirëkuptimi.....	7
Klasa I/ Rregullat dhe mirësjellja	13
Klasa II/ Dhuna si shkelje e të drejtave të fëmijëve.....	19
Klasa III/ Njohja e sjelljeve të dhunshme.....	25
Klasa IV/ Shkaqet dhe format e dhunës	31
Klasa V/ Zgjidhja e konflikteve në mënyrë jo të dhunshme	35
Klasa VI/ Komunikimi si mënyrë e tejkalimit të problemeve.....	41
Klasa VII/ Paragjykimi dhe diskriminimi	47
Klasa VIII/ Llojet e dhunës dhe raportimi	53
Klasa IX / Delikuenca e të miturve.....	59
Përfundimi	64
Përkufizimet.....	65
Materialet që mund të përdoren për realizimin e temave mësimore.....	67

HYRJE

Dhuna është problem global dhe i kalon kufijtë gjinorë, të racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik ose mendimeve të tjera, origjinës kombëtare ose sociale, pronës, lindjes, orientimit seksual, gjendjes shëndetësore, nevojave të veçanta a ndonjë statusi tjetër. Si e tillë, dhe e dëmshme për çdo shoqëri, dhuna kërkon mobilizimin dhe përkushtimin e institucioneve shtetërore për ta parandaluar dhe për ta trajtuar me efikasitet. Në të kundërtën, neglizhenca dhe mosvëprimi i institucioneve paraqet shkeljen e të drejtave të njeriut, që garantohen me konventat ndërkombëtare.

Të gjitha format e dhunës, abuzimit, neglizhencës, dhe keqtrajtimit, që rrezikojnë ose dëmtojnë integritetin fizik, mental dhe moral të fëmijës, përbëjnë një shkelje të të drejtave themelore të fëmijës, të përcaktuara me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, veçanërisht në nenin 19 të saj, parasheh detyrimin e qartë, që shtetet t'i mbrojnë fëmijët nga të gjitha format e dhunës, në të gjitha kohët dhe rrethanat. Ndonëse, legjislacioni në fuqi, duke filluar nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet relevante sektoriale, e sanksionojnë dhunën bazuar në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës/njeriut, prapëseprapë inspektimet, hulumtimet dhe projektet nëpër vite kanë evidentuar praninë e dhunës në nivele të ndryshme, si dhe në relacione të ndryshme brenda shoqërisë sonë.

Hulumtimet dhe projektet brenda institucioneve arsimore nxorën në pah dhunën në shkolla, në forma të ndryshme, si: fyerje nga ana e arsimtarit, ndëshkim fizik, fyerje

dhe ngacmime ndërmjet nxënësve, nënçmim ndaj arsimtarëve, ndalim i shprehjes së lirë, si dhe shkaqe e faktorë si nga ata individualë, ashtu edhe familjarë dhe shoqërorë, ku këta të fundit lidhen kryesisht me pasojat e luftës, pabarazinë shoqërore-ekonomike, urbanizmin dhe mbipopullimin, zhvillimin e shpejtë ekonomik dhe teknologjik, disponueshmërinë e armëve, etj. Në mënyrë të veçantë, sa i përket faktorit shkollë, janë evidentuar mangësi në respektimin e ligjit, të rregullave shkollore, të kodit të mirësjelljes, si dhe të udhëzimeve administrative, që e rregullojnë funksionimin e sistemit të arsimit dhe krijimin e raporteve të shëndosha në relacionin nxënës-arsimtar, nxënës-nxënës, udhëheqës-arsimtar dhe prind-arsimtar. Për ta adresuar dhe tejkaluar këtë problematikë, MASHT-i me partnerë realizoi projekte të shumta për parandalim të dhunës. Së fundi, u hartua dhe u aprovua Rregullorja 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar, i cili përcakton detyrimet, qartëson rolet dhe procedurat e institucioneve për parandalimin, identifikimin, mbledhjen e të dhënave, referimin, trajtimin dhe raportimin e dhunës ndaj fëmijëve në institucionet e arsimit parauniversitar.

Manuali didaktik për parandalimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar është një hap i mirë në drejtim të zbatimit të Protokollit 21/2013.

Rëndësia dhe qëllimi i manualit

Manuali didaktik, krahas Protokollit 21/2013 është mjaft i rëndësishëm për rritjen e vetëdijësimit kundër dhunës, të të gjithë atyre që marrin dhe japin shërbime brenda institucioneve arsimore parauniversitare.

Qëllimi i këtij Manuali është parandalimi i dhunës në shkolla nëpërmjet procesit të rregullt edukativo-arsimor, në arsimin e obliguar (1-9) parauniversitar. Me zbatimin efikas të Manualit, mësimdhënësit mund ta rrisin performancën e tyre të mësimdhënies dhe mësimnxënies, në vetëdijësimin mbi trajtimin e përshtatshëm të problematikës së dhunës, duke i kultivuar dhe promovuar te nxënësit vlerat e qytetërimit, sjelljet e shëndosha, shmangien e situatave konfliktuoze, si dhe reflektimin e edukatës dhe mirësjelljes adekuate, si në klasë e shkollë, ashtu edhe jashtë: në rrugë, familje dhe shoqëri.

Struktura

Siç shihet, Manuali në strukturën e vet përmban pjesën hyrëse, me shpjegime mbi problematikën e dhunës, format në të cilat shfaqet ajo, si dhe me kronologjinë e përmbledhur të punës, në parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës, në institucionet arsimore. Më tej, paraqiten aspektet psikologjike: zhvillimi kognitiv, zhvillimi emocional dhe kapacitetet e fëmijëve të moshave të ndryshme në procesimin e informacioneve, për të vazhduar me modelin e njëjësive mësimore për secilën klasë dhe moshë të nxënësve. Këto njësi mësimore mund të realizohen në kuadër të fushës **Shoqëria e Mjedisi**, por edhe në korrelacion me fusha të tjera kurrikulare, e pse jo edhe në kuadër të lëndëve zgjedhore. Në fund, Manuali përmbillet me një sqarimin të shkurtër për mësimdhënësin,

me përkufizimet mbi nocionet relevante, që u shërbejnë mësimdhënësve brenda temave që zgjedhin dhe me fletë pune, të cilat mund t'i shfrytëzojnë për zhvillimin e orëve mësimore.

Save the Children në Kosovë

Save the Children, në bashkëpunim me MASHT-in dhe ekspertë të fushave përkatëse, përmes zhvillimit dhe publikimit të këtij "Manuali didaktik për parandalimin e dhunës" do të kontribuojnë në ngritjen e burimeve që do të lehtësojnë zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Ky manual praktik do të nxis interesimin e nxënësve dhe mësimdhënësve; do të mundësojë që fëmijët të fitojnë njohuri; do t'i motivojë ata/ato që aktivisht të mësojnë dhe të aplikojnë strategji të ndryshme të mësim-it; dhe do t'i inkurajojë ata/to të mendojnë kritikisht në veçanti. Qëllimi i përgjithshëm i këtij Manuali është që të përkrah mësimdhënësit e shkollave fillore (nga klasa para-fillore deri tek klasa IX) të zhvillojnë sesione/njësi mësimore interaktive me nxënësit e tyre, të paktën një herë përgjatë vitit shkollor, në të gjitha klasat. Përveç kësaj, ai synon të rrisë njohuritë dhe vetëdijen e nxënësve në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me dhunën ndaj fëmijëve.

Përkushtimi i Save the Children në Kosovë dhe akterëve të tjerë në këtë fushë, që punojnë në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të mbrojtur shkollor; në promovimin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të fëmijëve; dhe promovimin e perspektivës mbi të drejtat e fëmijës tek autoritetet lokale e qendrore dhe organizatat e shoqërisë civile, do të ketë ndikim të gjerë pozitiv tek fëmijët në shkolla, familje dhe komunitete në të ardhmen.

KLASA PARAFILLORE

(5-6 VJEÇARËT)

■ **Zhvillimi kognitiv:** Fëmijët në këtë moshë zakonisht mund të numërojnë deri në 10 ose më shumë, vizatojnë trupin e njeriut, me së paku 6 pjesë të trupit. Me zhvillimin e mendimit simbolik, në këtë moshë mund t'i replikojnë disa shkronja ose numra, që i kanë mësuar nga të tjerët. Po ashtu, mund të kopjojnë forma të ndryshme gjeometrike, si: trekëndëshin, rrethin a forma të tjera.

■ **Zhvillimi emocional:** Në këtë moshë, shoqërimi me moshatarët bëhet edhe më i rëndësishëm për fëmijën. Ai, përpos që dëshiron të shoqërohet, dëshiron edhe t'i plotësojë dëshirat e moshatarëve. Në këtë moshë, fëmijët manifestojnë një tendencë për t'u pajtuar më shumë me rregullat e caktuara, krahasuar me një vit më parë. Fëmijët në këtë moshë janë të vetëdijshëm për gjininë dhe për disa dallime gjinore dhe tregojnë më shumë pavarësi. Shembull, mund të shkojnë prej një vendi në një vend tjetër.

■ **Procesimi i informacionit:** Në këtë moshë, ende nuk mund t'i kryejnë detyrat që kanë të bëjnë me aspekte konceptuale të numrit, gjatësisë, peshës dhe vëllimit. Kuptojnë se tinguj të caktuar përfaqësohen nga shkronjat dhe mund të fillojnë të shkruajnë. Po ashtu, në këtë moshë, fëmijët mund të diskutojnë tregime të ndryshme dhe t'i ri-tregojnë ngjarjet e tyre. Shumica e fëmijëve shkojnë në klasën para-filllore si dëgjues aktivë dhe entuziastë. Marrëdhëniet ndërnyerëzore janë shumë të rëndësishme. Janë të ndjeshëm ndaj informacionit që pranojnë dhe shumë lehtë krijojnë qëndrime pozitive ose negative për personat dhe gjërat, varësisht nga informacioni që marrin. Kanë dëshirë të krijojnë raporte të mira me të rriturit dhe bashkëmoshatarët, dhe kënaqen duke komunikuar me ta. Kjo është faza kur ata/ato e zhvillojnë vetëbesimin, vetë-respektin dhe vetëpërmbytjen. Zakonisht, zgjedhin që të punojnë në grupe. Janë jashtëzakonisht të ndjeshëm ndaj dhunës dhe kanë nevojë për përkrahjen e të rriturve, nga të cilët ndjehen të trajtuar si individë të veçantë dhe të cilët me ndjeshmëri marrin pjesë në lojën e tyre.

TEMA: BARAZIA DHE MIRËKUPTIMI

Kompetencat e synuara

Përmes kësaj teme synohet të arrihen elementet e kompetencave: *Komunikues efektiv, Mendimtar kreativ, Nxënës i suksesshëm, Kontribues produktiv, Individ i shëndoshë, Qytetar i përgjegjshëm*. Konkretisht, rezultatet: I. 3, 6; II. 7; III. 3; IV. 4; V. 6; VI. 2, 4 të shkallës së parë të Kurrikulës Bërthamë (shih KB për klasën parafillore dhe arsimin fillor, f. 20-23).

Qëllimi

Zhvillimi i kësaj teme ka për qëllim që fëmijët përmes lojës dhe bashkëbisedimit të bëhen të vetëdijshëm për mënyrat, përmes së cilave ata i kërkojnë dhe i pranojnë gjërat në jetë. Fëmijët do të arrijnë t'i njohin ngjashmëritë dhe dallimet, ata do të mësojnë t'i kuptojnë dhe t'i respektojnë dallimet që kanë të tjerët. Në këtë mënyrë krijojnë një atmosferë të besimit në grup dhe një atmosferë pozitive mësimi në të ardhmen.

Rezultatet e të nxënësve

Gjatë trajtimit të kësaj teme, nxënësit:

- do të mësohen ta bëjnë dallimin ndërmjet sjelljeve të pranueshme dhe të papranueshme në mjedisin e tyre;
- do të dinë dhe të kuptojnë, që dhuna është e papranueshme;
- do të arrijnë t'i njohin sjelljet e papranueshme.

PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSVE

Metodologjia e mësimdhënies

Është shumë e rëndësishme, që të krijohet një atmosferë e gëzueshme dhe shoqërore. Hapësira ku do të zhvillohet njësi mësimore duhet të përgatitet paraprakisht dhe karriget duhet të jenë të renditura në gjysmë-rreth. Ambienti duhet të korrespondojë me temën që do të trajtohet. Vendosen porosi shoqërore në vende sa më të dukshme, p.sh.: “Shoqëria është pasuri”; “Është mirë të kemi shokë/shoqe”; “Të gjithë jemi të barabartë” dhe porosi të tjera të ngjashme.

Materialet e nevojshme:

- Letra me ngjyra;
- Lapsa me ngjyra;
- Dërrasë e zezë ose fletë e madhe e bardhë;
- Shkumës (marker)
- Një kukull;
- Kube për formimin e formave të ndryshme;
- Balona.

Koha e nevojshme për zhvillim të temës

60 minuta.

ZHVILLIMI I TEMËS:

1. Orën mësimore e filloni duke sfiduar fëmijët që ta tregojnë shokun/shoqen e ngushtë dhe raportet e mira që kanë mes vete.
2. Lexoni tekstin me shkronja kursive (*italic*) për fëmijët dhe sigurohuni që

e keni vëmendjen e të gjithë fëmijëve. (Ofroni kohë të mjaftueshme që fëmijët të përgjigjen në pyetjet që do t'i bëni. Pasi të merrni përgjigjet që prisni t'i merrni, vazhdoni leximin e pjesës në vazhdim. Nëse nuk jeni të kënaqur me përgjigjet që merrni, bëni pyetje të hapura dhe të thjeshta që i sfidojnë fëmijët t'i përshkruajnë qëndrimet e tyre rreth çështjes së caktuar).

Ky është një tregim për dy motra: Vlerën dhe Diellën. Zakonisht, ato kalojnë shumë mirë së bashku. Ato luajnë, bisedojnë dhe i ndajnë gjërat me njëra-tjetrën. Por, nganjëherë, ato kanë moskuptime. Si në rastin e tanishëm. Vlera e ka një kukull. Diella dëshiron të luajë me kukullën e Vlerës.

3. Pyetni fëmijët: Çfarë duhet të bëjë Diella, që të marrë kukullën nga Vlera?
4. Kur fëmijët japin idetë e tyre, listoni idetë (në dërrasë të zezë ose në fletë të madhe të bardhë) të ndara në tri kolona, sipas varianteve të dhëna më poshtë, për të cilat do të diskutoni në vazhdim:
 - a. Varianti 1: Diella duhet ta rrëmbejë kukullën nga Vlera!
 - b. Varianti 2: Vlera dhe Diella duhet të arrijnë një marrëveshje!
 - c. Varianti 3: Diella duhet ta kërkojë ndihmën e nënës!

Diskutimi rreth variantit të parë: Diella duhet ta rrëmbejë kukullën nga Vlera!

4. Lexoni me zë skenarin e variantit të parë të paraqitur në tekstin më poshtë:

Diella rrëmbeu kukullën nga Vlera. Tani ajo është duke luajtur me kukullën. Ajo është ulur larg nga Vlera dhe po luan vetëm.

5. Pyetni fëmijët:
 - a. Si po ndjehet Vlera në këtë situatë? Përgjigjet e mundshme: Vlera është e pikëlluar dhe e zemëruar. Edhe ajo dëshiron të luajë me kukullën. Ajo ende nuk e kishte përfunduar lojën.
 - b. Çfarë mendoni se do të ndodhë në vazhdim? Përgjigjet e mundshme: Vlera vendos ta merr kukullën e saj. Ajo shkon te Diella dhe menjëherë ia merr kukullën asaj. Vlera vazhdon të luajë me kukullën e saj.
 - c. Si po ndjehet Vlera tani? Përgjigjet e mundshme: Ajo është e gëzuar. Ajo ka kukullën dhe vazhdon të luaj me të.
 - d. Çfarë mund të bëjë Diella tani?
 - i. Ta arrijë një marrëveshje me Vlerën!
 - ii. Ta kërkojë ndihmën e nënës!

Diskutimi rreth variantit të dytë: Vlera dhe Diella duhet të arrijnë një marrëveshje!

5. Lexoni me zë skenarin e variantit të dytë:

Diella ka vendosur të bëjë një marrëveshje. Ajo e pyet Vlerën: “Me çka dëshiron të luash?”. Vlera i përgjigjet: “Unë dua ta ndërtoj një shtëpi me kubet tuaja”. Diella pajtohet: “Unë do t'i jap kubet e mia, kurse unë do të luaj me kukullën tënde”. Tani, Diella është duke

luajtur me kukullën, kurse Vlera është duke ndërtuar një shtëpi me kube.

6. Pyetni fëmijët:

a. Si po ndjehet Diella tani?

Përgjigjet e mundshme: Ajo është e gëzuar. Ajo po luan me kukullën.

b. Si po ndjehet Vlera?

Përgjigjet e mundshme: Edhe Vlera është e gëzuar. Ajo luajti më kukullën e para dhe tani po ndërton shtëpinë me kubet formuese.

c. A ju pëlqen kjo zgjidhje?

Diskutimi rreth variantit të tretë:
Diella duhet ta kërkojë ndihmën e nënës!

4. Lexoni me zë skenarin e variantit të tretë:

Diella shkon te nëna dhe i thotë:

“Nënë, Vlera e ka kukullën dhe është duke luajtur me të që një kohë të gjatë. Tani dua të luaj unë me kukullën. Të lutem, merre kukullën nga Vlera dhe ma jep mua”.

5. Pyetni fëmijët:

a. Çfarë mendoni se do të veprojë nëna?”

Përgjigjet e mundshme: Nëna i thotë Diellës që të pres derisa Vlera ta përfundojë lojën me kukullën; Nëna i thotë Vlerës se është radha e Diellës, që të luajë me kukullën dhe duhet t’ia jap asaj; Nëna e ndihmon Diellën që të gjejë ndonjë lodër tjetër për të luajtur.

b. Si do të ndjehen Vlera dhe Diella?

c. Çfarë do ta bënte Vlerën të lumtur?

d. Çfarë do ta bënte Diellën të lumtur?

e. Çfarë do t’i bënte të dyja, Vlerën dhe Diellën, të lumtura?

6. Sfidu fëmijët që të luajnë me një balon, të cilin do ta godasin duke mos e lënë që të bie në tokë. Dhoma në të cilën luajnë duhet të jetë e pas-truar nga objektet që mund të jenë pengesa, në të cilat mund të lëndohen fëmijët. Kërkoni nga fëmijët që të bashkëpunojnë dhe të kenë mirëkuptim për njëri-tjetrin përgjatë rrjedhës së lojës. Diskutoni me fëmijët rreth ndonjë sjelljeje të papranueshme, që eventualisht mund të shkaktohet përgjatë rrjedhës së lojës në grup.

KLASA I

(6-7 VJEÇARËT)

■ **Zhvillimi kognitiv:** Te fëmijët e moshës 6 vjeçare ngërthehen fazat e fundit të zhvillimeve para-operacionale. Kohë kjo, kur fëmijët fillojnë ta përdorin gjuhën më me kompetencë. Në këtë moshë, fëmijët e zhvillojnë të kuptuarit intuitiv të koncepteve në disa fusha, përderisa në të tjerat janë kryesisht me perceptim. Fëmijët e kësaj moshe besojnë se objektet dhe kafshët mendojnë sikur njerëzit.

Zhvillim tjetër është aftësia për ta dalluar fantazinë nga realiteti. Përshkrimi i ngjashmërive ndaj objekteve, gjithashtu është karakteristikë për moshën 6 dhe 7 vjeçare, gjë që mundëson zhvillimin e kategorive në të menduar.

■ **Zhvillimi emocional:** në këtë moshë, fëmijët 6 vjeçarë bëhen më të vetëdijshëm për emocionet e tyre dhe të të tjerëve. Janë ende të vetë-qendëruar (nuk mund ta marrin perspektivën e personave të tjerë, egocentrizmi), pak të pasigurt, dëshirojnë lëvdata dhe janë të ndjeshëm ndaj kritikave. Shoqëria është e rëndësishme, por kryesisht preferojnë të luajnë me gjininë e njëjtë. Tani bëjnë krahasime të vetes së tyre me moshatarët e tjerë, dhe i bënë të ndihen të cenuar në identifikimin e dobësive dhe krenarë për identifikimin e fuqive që mund t'i kenë.

■ **Procesimi i informacionit:** Në këtë moshë, mësohet të lexuarit te fëmijët. Gjithashtu, rritet opusi i fjalëve dhe koncepteve me të cilat veprojnë, si dhe aftësitë për të shqiptuar fjalë.

Në gjysmëvjetorin e dytë, fëmijët janë në gjendje të krijojnë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.

Fëmijët, në klasën e parë, ballafaqohen me vështirësi të shumta, që vijnë kryesisht nga tranzicioni prej një ambienti të njohur mirë, si institucioni parashkollor/klasa parafillore, ose shtëpia, në një ambient krejtësisht të ri. Shkolla për ta është një mjedis kompleks, ku ka shumë aspekte, me të cilat duhet të ballafaqohen. Përshatja me rrethin, kushtet dhe rregullat e reja është sfidë në vete. Ndjenja e përkatësisë është jashtëzakonisht e rëndësishme. Zakonisht, nxitojnë kur punojnë, kanë tendencë konkurruese të theksuara dhe janë tepër të ndjeshëm ndaj kritikave dhe dhunës. Fillojnë të jenë në gjendje ta konceptojnë të kaluarën, të tashmen, shkakun dhe pasojën. Megjithatë, gjykimet ekstreme si 'i/e mirë' dhe 'i/e keq/e' vazhdojnë të jenë të theksuara.

TEMA: RREGULLAT DHE MIRËSJELLJA

Kompetencat e synuara

Përmes kësaj teme synohet të arrihen elementet e kompetencave: *Komunikues efektiv, Mendimtar kreativ, Nxënës i suksesshëm, Kontribues produktiv, Individ i shëndoshë, Qytetar i përgjegjshëm*. Konkretisht, rezultatet: I. 3, 7; II. 3, 4; III. 2, 3, 7; IV. 2, 4, 6; V. 1, 5; VI. 2, për shkallën e parë të Kurrikulës Bërthamë (shih KB për klasën parafillore dhe arsimin fillor, f. 20-23).

Qëllimi

Qëllimi i realizimit të kësaj teme mësimore është njohja e nxënësve me rëndësinë e rregullave në mjedise të ndryshme dhe vetëdijësimi i tyre se respektimi i rregullave krijon shprehinë e mirësjelljes.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë trajtimit të kësaj teme, nxënësit:

- përshkruajnë lidhjen ndërmjet rregullave dhe mirësjelljes;
- shpjegojnë rëndësinë e rregullave për funksionimin e shoqërisë;
- krijojnë rregullat e klasës, duke u bazuar në të dhëna (fotografi) dhe në nevojat e tyre.

PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSVE

Metodologjia e mësimdhënies

Gjatë trajtimit të kësaj teme, në çdo hap, duhet ta keni parasysh moshën e fëmijëve dhe mundësitë e tyre. Mënyra më efektive, me anë të së cilës fëmijët e kësaj moshe përfitojnë njohuri është mësimi përmes lojës dhe aktiviteteve kreative. Gjithashtu, përdorimi i fotografive i ndihmon nxënësit në të shprehur dhe në arritjen e konkluzioneve. Sepse, konsiderojmë se fëmijët e kësaj moshe, ende nuk dinë mirë shkrim-lexim. Gjatë zhvillimit të kësaj teme, nxënësit i ushtrojnë rregullat e mirësjelljes dhe provojnë të hartojnë rregulla në përputhje me kërkesat e moshës së tyre. Kjo bëhet përmes aktiviteteve: Karrige e veçantë dhe Rregulla “Pizza”.

Me rastin e hartimit të rregullave duhet pasur kujdes që nga nxënësit të mos kërkohet të hartohen shumë rregulla. Ideja e kësaj teme është që nxënësit të njihen me konceptet- mirësjellje dhe rregull, dhe ta kuptojnë lidhshmërinë ndërmjet tyre.

Materialet e nevojshme:

- dërrasa e zezë;
- mundësisht, fleta me ngjyra;
- shkumës (marker me ngjyra të ndryshme);
- fotografi, që lidhen me temën (mund të merren nga gazetatat, interneti, të vizatohen nga mësimdhënësi ose nga burime të tjera);
- fleta të prera në formë gjysmërrethi - $\frac{1}{4}$ e rrethit;
- pliko;
- gërshtë dhe ngjitës.

(Mund të përzgjidhni mjete në përputhje me kreativitetin tuaj, por gjithnjë në funksion të moshës së nxënësve dhe përmbajtjes së temës).

Koha e nevojshme për zhvillim të temës

Një orë mësimi.

ZHVILLIMI I TEMËS:

Orën mësimore e filloni me aktivitetin "Karrige e veçantë". Ky aktivitet realizohet sipas kësaj procedure:

1. Afër dërrasës së zezë, përballë të gjithë nxënësve, vendosni një karrige;
2. Ftoni ndonjërin prej nxënësve që të ulet në të;
3. Të gjithë nxënësit e klasës afrohen afër tij/saj, duke e rrethuar, dhe me rend i flasin nga një fjalë të bukur (mund të ndodhë që disa nxënës t'i përsërisin fjalët e njëjta, por ju nuk duhet të ndërhyjnë);
4. Personi në karrige ka për detyrë të thotë vetëm "Faleminderit!" dhe asgjë tjetër.

Të njëjtën procedurë mund ta vazhdoni edhe me dy nxënës të tjerë radhazi. Do të thotë, një herë njëri nxënës ulet në karrige, pastaj tjetri dhe nxënësit e tjerë që qëndrojnë në këmbë flasin fjalë të mira, ndërsa nxënësi që rri ulur thotë vetëm "Faleminderit!" (Secili nga këta tre nxënës mund të qëndrojnë ulur deri në tre minuta).

5. Pasi të tre nxënësit ngrihen nga karriga, së bashku qëndrojnë në mes të rrethit të nxënësve, që u thonin fjalë të mira. Ju i pyesni se si ishin ndier kur të tjerët u thonin fjalë të bukura.

Pas këtij aktiviteti, në dërrasë të zezë vendosni katër fletë të formatit A4 me ngjyra të ndryshme, ku keni shkruar: *Faleminderit, Ju lutem, Më falni dhe Urdhëroni*. Pastaj, i pyesni nxënësit se kur e përdorim secilën nga këto shprehje? Përgjigjet e mundshme të nxënësve mund të jenë:

- ✓ *Faleminderit*, mund të themi kur dikush na jep diçka ose na ndihmon për diçka;
- ✓ *Ju lutem*, mund të themi kur nga të tjerët kërkojmë diçka, p.sh. *Ju lutem më ndihmoni!*
- ✓ *Më falni* mund të themi kur e pengojmë dikë...
- ✓ *Urdhëroni* - kur dikujt duam t'i kryejmë një shërbim...

Mbi bazën e përgjigjeve të nxënësve mund të vini deri te koncepti i rregullit, duke u thënë nxënësve:

- ✓ Se, rregull qenka, që çdo herë duhet falënderuar të tjerët kur na ndihmojnë diçka...
- ✓ Se, rregull qenka, që çdo herë të themi të *lutem* kur nga të tjerët kërkojmë diçka...
- ✓ Se, rregull qenka, që çdo herë duhet kërkuar falje kur bëjmë gabime dhe kur nga të tjerët kërkojmë diçka...
- ✓ Se, rregull qenka, që çdo herë duhet t'u themi të tjerëve *Urdhëroni* kur duam t'u kryejmë ndonjë shërbim...

Më pas, vazhdoni diskutimin duke e orientuar atë në kuptimin e mëtejshëm të rregullave me anë të pyetjes: *Pse kemi nevojë për rregulla?* Pas përgjigjeve të nxënësve, orën mësimore e përfundoni me aktivitetin "**Rregulla 'Piz-za'**", të cilin e zhvilloni sipas kësaj procedure:

1. Ndani nxënësit në katër grupe;
2. Secilit grup i jepni nga një pliko dhe $\frac{1}{4}$ e rrethit me diametër 80 cm (Në

plikot e secilit grup duhet të ketë fotografi të ndryshme, që përfaqësojnë këto fusha kurrikulare: *Shëndetin dhe mirëqenien, Shoqërinë dhe mjedisin, Gjuhët dhe komunikimin, dhe Jetën dhe punën.* (shih KB e klasës parafilllore dhe arsimit fillor));

3. Detyra e secilit grup është të krijojë një rregull të klasës, duke u bazuar në fotografi. (për 5 minuta).

P.sh:

- Në plikon e fushës kurrikulare *Shëndeti dhe mirëqenia* duhet të ketë fotografi, ku paraqitet klasa e pastër, nxënës duke kryer rutinën e mëngjesit, duke vrapuar, ushqim të shëndetshëm, etj.;
- Në plikon e fushës *Shoqëria dhe mjedisi* duhet të ketë fotografi, ku paraqitet kujdesi për lulet, ku mbe-turinat hedhen në shportë, rregullat e ndonjë loje (loja fer)...;
- Në plikon e fushës *Gjuhët dhe komunikimi* duhet të ketë fotografi, ku hetohen shprehjet e mirësjelljes;
- Në plikon *Jeta dhe puna* duhet të ketë fotografi për rreziqet e prekjes jo të drejtë të prizës së rrymës elektrike, e fotografi të ngjashme. Nxënësve nuk u tregohet për ndarjen e fotografive sipas fushave kurrikulare, sepse ata janë të vegjël për t'u ballafaquar me këto nocione).

Rregullat e mundshme, të dalta nga analiza e fotografive, që bëjnë nxënësit mund të jenë:

- Ne e mbajmë klasën të pastër;
- Ne i respektojmë rregullat e lojës;
- Ne e respektojmë njëri-tjetrin;
- Ne nuk luajmë me rrymë elektrike;

- Ne themi fjalë mirësjelljeje kur flasim me të tjerët.

(Është e rëndësishme që nxënësit t'i udhëzoni që rregullat t'i përpilojnë në formë pohimi dhe të jenë në kontekstin pozitiv).

Pas përpilimit të rregullave, në secilin grup caktohet një nxënës që do ta shkruajë rregullën e nxjerrë mbi bazën e fotografive në $\frac{1}{4}$ e rrethit. Të tjerët i prejnë fotografitë, nga të cilat e kanë nxjerrë rregullën, dhe i ngjesin afër rregullave përkatëse, kurse një nxënës do t'i prezantojë ato.

(Nëse nxënësit nuk i kanë mësuar të gjitha shkronjat, ata mund të udhëzohen që fjalët t'i kombinojnë me fotografi të prera).

Më pas, në dërrasë të zezë ose në mur, i bashkojmë (ngjesim) katër pjesët e rrethit me katër rregullat dhe njëkohësisht formojmë "Rregullën 'Pizza'". Në fund, me të gjithë nxënësit lexoni bashkërisht rregullat e vendosura në "Rregullën 'Pizza'".

KLASA II

(7-8 VJEÇARËT)

■ **Zhvillimi kognitiv:** Kuriozitet i madh për dukuri nga më të ndryshmet. Në këtë moshë kemi zhvillim të hovshëm gjuhësor. Gjuha bëhet më komplekse. Të lexuarit dhe të kuptuarit përmirësohen ndjeshëm.

Zhvillohet aftësia për t'i manipuluar elementet simbolike. Në këtë fazë, fëmijët fillojnë të jenë në gjendje t'i shohin gjërat nga perspektiva e tjetrit. Fëmijët e kësaj moshe besojnë se objektet dhe kafshët e tjera mendojnë sikur njerëzit. Duke qenë se fëmijët e kësaj moshe futen në fazën e operacioneve konkrete, ata fillojnë ta zhvillojnë të menduarit logjik, gjithnjë të ndërlidhur me objekte fizike konkrete. Në këtë moshë përmirësohen shkathtësitë planifikuese.

■ **Zhvillimi emocional:** Kontrollim më i mirë i impulseve. Bëhen më të ndjeshëm për emocionet e të tjerëve. Fillojnë t'i largojnë frikësimet e paarsyeshme. Ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme shoqërore, sidomos me fëmijët e gjinisë së njëjtë. Presioni nga moshatarët për t'iu bindur pritjeve të grupit rritet. Shpesh herë mund të shprehin brengë se nuk pëlqehen nga të tjerët, si dhe për aftësitë e tyre kur krahasohen me moshatarët e tjerë.

■ **Procesimi i informacionit:** Në këtë moshë, ndikimet kontekstuale dhe ndërveprimi me të tjerët janë vendimtare. Kureshtja është e shtuar dhe rrjedhimisht ata kanë më shumë motiv për të mësuar. Kanë një perceptim solid të kohës dhe kanë kapacitet të mirë për t'i riorganizuar informacionet në aspektin kohor. Fillojnë ta zhvillojnë stilin e tyre të të mësuarit. Fillojnë të mësojnë se si ta menaxhojnë një konflikt dhe të arrijnë ta tolerojnë zhgënjimin dhe ngacmimin, kur e konsiderojnë të arsyeshëm. Fëmijët 7-8 vjeçarë mund të dëgjojnë për periudha më të gjata kohore, duke absorbuar informata të reja dhe arrijnë t'i kuptojnë shakatë, thumbat dhe sarkazmin. Duke shkruar në lidhje me atë që lexojnë, arrijnë t'i lidhin konceptet me përvojën e tyre personale. Në këtë moshë, fëmijët janë më të ndjeshëm ndaj mënyrës se si të tjerët i trajtojnë dhe shqetësohen me mënyrën se si reagojnë të tjerët në rrethana të caktuara. Përveç kësaj, mund të provojnë t'i zgjidhin problemet përmes disa sjelljeve agresive.

TEMA: DHUNA SI SHKELJE E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Kompetencat e synuara

Përmes kësaj teme synohet të arrihen elementet e kompetencave: *Komunikues efektiv, Mendimtar kreativ, Nxënës i suksesshëm, Kontribues produktiv, Individ i shëndoshë, Qytetar i përgjegjshëm*. Konkretisht, rezultatet: I. 3, 8; II. 2, 8; III. 3, 4; IV. 3; V. 6; VI. 2 për shkallën e parë të Kurrikulës Bërthamë (shih KB për klasën parafillore dhe arsimin fillor f. 20-23).

Qëllimi

Qëllimi i realizimit të kësaj teme mësimore është që nxënësit t'i zhvillojnë njohuritë për konceptin e dhunës, ta kuptojnë dhunën si shkelje e të drejtave të tyre dhe t'i zhvillojnë shkathtësitë e parandalimit të situatave të dhunshme.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë trajtimit të kësaj teme, nxënësit:

- identifikojnë raste të shkeljes së të drejtave të fëmijëve në situata të ndryshme;
- demonstrojnë shkathtësi mbrojtëse, si mjet parandalues i situatave të dhunës;
- krijojnë materiale, që i thonë stop dhunës (Posterë).

PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSVE

Metodologjia e mësimdhënies

Trajtimi i çështjes së abuzimit të fëmijëve ndihmon që fëmijët ta kuptojnë të drejtën e tyre për të qenë të sigurt, si dhe të jenë në gjendje të flasin kur ndjehen të kërcënuar ose të pasigurt. Zhvillimi i kësaj teme mund të realizohet nëpërmjet disa aktiviteteve në formë loje, në mënyrë që fëmijët t'i identifikojnë të drejtat e tyre. Në këtë kontekst, përgatitja e posterëve, loja “*Luani, miu dhe elefanti*”, dhe analiza e vjershës “*Ngrite zërin*” janë disa nga aktivitetet, që nxënësve ua bëjnë më të lehtë ta njohin konceptin e dhunës, ta kuptojnë dhunën si shkelje e të drejtave të tyre dhe t'i zhvillojnë shkathtësitë e parandalimit të situatave të dhunshme. Gjithashtu, nëse e shihni të arsyeshme, mund ta përzgjidhni ndonjë vjershë tjetër ose tregim për trajtimin e kësaj teme. Por, është mirë që teksti të mos jetë i gjatë dhe gjuha e shkrimit të jetë në përputhje me moshën e fëmijëve.

Materialet e nevojshme:

- gazeta;
- fletë të vizatimit;
- kopje të vjershës “*Ngrite zërin*” (marr nga libri “*Gjuha shqipe 3*”, Shtëpia Botuese Pegi, 2011);
- markerë, ngjites, gërsërë, shkumës, dërrasa e zezë..

Koha e nevojshme për zhvillim të temës

Një orë mësimi.

ZHVILLIMI I TEMËS:

Zhvillimin e temës e filloni me përgatitjen e posterëve, të cilët duhet të jenë në funksion të të drejtave të fëmijëve. Këtë aktivitet e zhvilloni sipas kësaj procedure:

1. ndani nxënësit në grupe (numri i grupeve mund të jetë i ndryshëm, varësisht nga numri i nxënësve në klasë. Secili grup të jetë heterogjen nga aspekti gjinor);
 2. shpërndani gazeta dhe fleta të vizatimit për secilin grup dhe u jepni udhëzimet se si të përgatitet posteri;
 3. ndihmoni nxënësit e secilit grup ta vendosin titullin e posterit (titujt, të cilët mund të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të pritshme për këtë aktivitet, mund të jenë:
 - Gjërat që më ndihmojnë të ndihem i shëndetshëm;
 - Gjërat që më ndihmojnë të ndihem i lumtur;
 - Gjërat që më ndihmojnë të ndihem i sigurtë
1. nxënësit e secilit grup e krijojnë posterin mbi bazën e titullit të përzgjedhur dhe e vendosin në muret e klasës;
 2. nga një pjesëtar i secilit grup prezanton punën e bërë të grupit para klasës, dhe pas çdo prezantimi, lini pak kohë për diskutime. (Prezantuesin mund ta zgjedhin vetë nxënësit e grupit).

Mbi bazën e prezantimeve të nxënësve dilni natyrshëm te qëllimi i temës, *Dhuna si shkelje e të drejtave të fëmijëve*. Do të thotë, nxënësit i njoftoni për temën, e cila do të mësohet gjatë orës mësimore.

Pas njoftimit me temën e orës mësimore, nxënësve u shpërndani kopje të vjershës “*Ngrita zërin*” me këtë përmbajtje:

*Epo, shumë jam mërzitur
me ç’po ndodh
në shtëpi.
Ta tregoj, sa për ta ditur
pastaj,
ja më thuaj ti:*

*M’i blen mami
tërë fustanet,
bishtalecat m’i thur gjyshja,
në shtëpi
më hidhet babi:
“Ja na erdhi dallëndyshja”.*

*Gjyshi nuk di tjetër punë:
“Mos këtu e mos atje.”
“Në shkollë sot!?”
“Oh, e çoj unë.
Vetëm, çupën nuk e le!”*

*Por një ditë kërkova mbledhje,
rreth tryezës,
në shtëpi,
të ngre zërin,
të bëj zgjedhje,
të vë pikat përmbi i:*

*“Ç’është kështu me ju zotërinj?
Mos si lodër ju jam dukur?
Unë jam vajzë,
jam fëmijë,
nuk jam zog,
e nuk jam kukull.*

*Nuk i dua bishtalecat
dhe fustanet
i zgjedh vetë.
Mos më thoni dallëndyshe,
por me emrin e vërtetë.*

*Unë kam emër shumë të bukur,
pa kam fjalë
e kam mendime,
kam inate dhe dëshira,
kam edhe të drejtën time!”*

*Ja kështu,
Qerpikpadridhur
i rendita fjalët vetë.
Se...harrojnë që jam rritur,
jam,
ohuuuu,
në klasë të dytë!*

(N. Porocani)

Pasi nxënësve u shpërndani kopjet e vjershës, kërkoni nga ata ta lexojnë vjershën në heshtje dhe t'i shkruajnë në fletore vargjet që u pëlqejnë, që nuk u pëlqejnë dhe që i lidh me jetën e tyre (Në këtë rast, ky aktivitet realizohet sipas teknikës: Ruaje fjalën e fundit për mua). Më pas, një nxënës i lexon me zë vargjet e përzgjedhura, sipas kërkesave (çka u pëlqen, ose çka nuk u pëlqen, ose çka i lidh me jetën...), por jo domosdoshmërisht t'u përgjigjet të gjitha kërkesave. Pas tij, nxënësit e tjerë, që i kanë përzgjedhur vargjet e njëjta, i lexojnë komentet e tyre. Në fund, e lexon komentin e tij nxënësi që i ka lexuar vargjet me zë. Kjo procedurë përsëritet edhe me disa nxënës, që i kanë përzgjedhur vargjet e tjera. (Gjatë leximit të komenteve, nga ana e nxënësve, kujdesuni t'i kanalizoni informacionet drejt njohjes së të drejtave të fëmijëve dhe sjelljeve të dhunshme që i cenojnë ato).

Në fund të orës luhet loja “*Luani, miu, elefanti*” me qëllim që nxënësit ta demonstrojnë fuqinë e vendosshmërisë së kundërshtimit karshi rasteve të dhunës, nëpërmjet lojës me kafshë.

Loja nis kështu:

- Ftoni tre nxënës, që të luajnë në role: luanin, miun dhe elefantin;
- Pyetni ata se si do t'i thonin JO diçkaje, secila nga këto kafshë, kur atyre që nuk u pëlqen diçka. (Dhe fillon loja):
- Luani qëndron arrogant dhe thotë JO me zë të zhurmshëm;
- Miu qëndron i strukur dhe thotë JO me zë të ulët;
- Elefanti qëndron me krenari dhe thotë JO në mënyrë të qartë e të fortë.

Pas lojës në role, diskutoni për mënyrën se si janë shprehur secila kafshë, në mënyrë të sigurt apo jo të sigurt.

Ideja kryesore e kësaj loje është që nxënësit të kuptojnë se duhet të jenë të vendosur dhe të sigurt në qëndrimet dhe reagimet e tyre ndaj dhunës, sikurse fuqia e këtyre kafshëve (elefantit apo luanit apo miut?).

KLASA III

(8-9 VJEÇARËT)

■ **Zhvillimi kognitiv:** Fëmijët në këtë moshë e zhvillojnë stilin e të menduarit operacional konkret. Ata mund të manipulojnë lirshëm me simbole. Gjithashtu, fillojnë të zhvendosen pak, drejt një manipulimi më abstrakt të tyre. Gjatë kësaj moshe, përsoset aftësia e konservimit të sasisë. Rezonimi i tyre bëhet më i saktë. Në këtë moshë fillon të zhvillohet ideja për pandryshueshmërinë e identitetit (gjërat mbeten ashtu siç janë). Fëmijët e kësaj moshe fillojnë të argumentojnë logjikshëm. Në këtë moshë, fëmija mund të decentralizohet, që do të thotë se mund t'i konsiderojë gjërat nga perspektiva e dikujt tjetër.

■ **Zhvillimi emocional:** Kënaqen kur janë me shokët dhe mendimet e shoqërisë bëhen përherë e më të rëndësishme. Fitojnë një sens sigurie, duke u ndarë në grupe. Mund të kenë shpërthime emocionale, si p.sh. të zemërimit. Bëhen pak të padurueshëm dhe kërkojnë plotësim të menjëhershme të dëshirave. Në moshë 7 a 8 vjeçare fëmijët zhvillojnë tri vetë-vlerësime të ndryshme për veten, atë: akademike, fizike dhe sociale; dhe kjo, në moshat e mëvonshme rafinohet edhe më shumë.

Në këtë moshë fillojnë të krijohen shoqëritë më të ngushta me nga 2, 3 a 4 anëtarë dhe tentojnë të veçohen, si dhe rezistojnë të pranojnë vajza ose djem të rinj në grup. Preferojnë të shoqërohen ende me gjininë e njëjtë, edhe pse kanë shumë informata për dallimet gjinore.

■ **Procesimi i informacionit:** Fëmijët në këtë moshë mund të lexojnë dhe të absorbojnë fjali të plota, por natyrisht të thjeshta. Mund të bëjnë mbledhje dhe zbritje.

Në këtë moshë, fëmijët janë në gjendje t'i kuptojnë elementet, që mund t'i paraprijnë konflikteve të ndryshme, përfshirë edhe atyre fizike. Me ata mund të punohet për të parë se si reagojnë kur ata zemërohen ose cilat janë alternativat ndaj këtyre reagimeve. Kapaciteti i tyre e mundëson zhvillimin e aktiviteteve, që kanë në përmbajtje shkak-pasojë, konflikte dhe diskutim për ndjenja. Kur ndërveprojnë me të tjerët ata kënaqen kur i ndajnë opinionet e tyre për tema të ndryshme. Ata e kanë të zhvilluar sensin e vetëbesimit dhe mund ta shfaqin frustrimin e tyre, si përgjigje ndaj temave dhe çështjeve ku ata janë të dobët. Fëmijët 8 vjeçarë e kuptojnë konceptin e maskimit të emocioneve dhe përdorin strategji të ndryshme, që t'i fshehin emocionet e tyre, kur gjinden në situata të papëlqyeshme.

TEMA: NJOHJA E SJELLJEVE TË DHUNSHME

Kompetencat e synuara:

Përmes kësaj teme synohet të arrihen elementet e kompetencave: *Komunikues efektiv, Mendimtar kreativ, Nxënës i suksesshëm, Individ i shëndoshë, Qytetar i përgjegjshëm*. Konkretisht, rezultatet: I. 4, 6; II. 3, 5; III. 1, 2; IV. 3, 5; V. 2, 6; VI. 1, 3, të shkallës së dytë të Kurrikulës Bërthamë (shih KB për klasën parafillore dhe arsimin fillor f. 25-29).

Qëllimi

Qëllimi i realizimit të kësaj teme mësimore është njohja e nxënësve me sjelljet e dhunshme dhe kuptimi i dhunës si qasje e papranueshme për zgjidhjen e çfarëdo mosmarrëveshjeje.

Rezultatet e të nxënësve

Gjatë trajtimit të kësaj teme, nxënësit:

- identifikojnë sjelljet e dhunshme në situata të ndryshme problemore;
- debatojnë rreth temave, të cilat janë të lidhura me sjelljet e dhunshme;
- propozojnë zgjidhje paqësore të situatave, që paraqiten gjatë diskutimeve.

PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSVE

Metodologjia e mësimdhënies

Për realizimin e kësaj teme mësimore mund të përdoren teknika të ndryshme, përmes së cilave vjen në shprehje kreativiteti i mësimdhënësve dhe nxënësve.

Ora mësimore fillohet me punën në grupe, për të vazhduar më pas me teknikën DRTA (Lexim i drejtuar përmes pyetjeve). Në fund të orës, në fazën kur nxënësit do ta praktikojnë çfarë kanë mësuar, mund të përdoren teknikat: “Shkrim të lirë”, “Ese 5 minutësh”, “Pesëvargësh”, “Krijë një poster”, etj.

Njohja e sjelljeve të dhunshme mund të arrihet përmes fushave të ndryshme kurrikulare, si: *Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shëndeti dhe mirëqenia; dhe Shoqëria dhe mjedisi*.

Materialet e nevojshme:

- kopje të tiketave me situata problemore;
- kopje të pjesës “Letra e Erës” marr nga libri “Gjuha shqipe” (Shtëpia Botuese Albas, 2007);
- letra, fotografi, gërvshërë, ngjitës dhe pliko.

(Për ta realizuar këtë temë mund të merrni tregime, përralla, poezi, letra të fëmijëve etj., që gjithsesi pëmbajnë elemente të dhunës. Kjo do të thotë që jo domosdoshmërisht mund të trajtohen tregimet e propozuara në udhëzues).

Koha e nevojshme për zhvillim të temës

Një orë mësimore.

ZHVILLIMI I TEMËS:

Orën mësimore e filloni me diskutimin rreth situatave të ndryshme problemore. Ky aktivitet realizohet sipas kësaj procedure:

1. ndani nxënësit në grupe (grupet të jenë me nxënës që kanë intelegjencë dhe stile të ndryshme të të nxënës, si dhe të gjinive të ndryshme. Bëni këtë përzgjedhje për arsyen e vetme, që të gjithë nxënësit të përfshihen në aktivitetet e parapara).
2. Në secilin grup paraqitni nga një "Situatë problemore" në formë të tiketave. Tiketatat mund të kenë këtë përmbajtje:
Tiketa 1: Një nxënës godet me grusht një nxënës tjetër;
Tiketa 2: Një prind i thotë vazhdimisht fëmijës së vetë "budalla dhe i pavlerë";
Tiketa 3: Shokët asnjëherë nuk e pranojnë në lojë një fëmijë me nevoja të veçanta;
Tiketa 4: Një grup nxënësish përqeshin shokun, shoqen ose një grup të nxënësve të tjerë.

(Mund të përdoren edhe tiketa me përmbajtje të tjera, nëse doni të trajtoni situata të tjera problemore. Situatat problemore duhet të përmbajnë së paku një formë të dhunës).

1. Kërkoni, që brenda 5 minutash nxënësit të diskutojnë në grup rreth situatës së caktuar.
2. Kërkoni, që secili grup, përmes përfaqësuesit të tij t'i prezantojë

argumentet e nxjerra. (Prezantimet të jenë të shkurtra, afërsisht 1 minut për secilin grup).

Nga argumentet e nxënësve dilni natyrisht të qëllimi i temës *Njohja e sjelljeve të dhunshme*. Do të thotë, nxënësit i njoftoni për temën, e cila do të mësohet gjatë orës mësimore.

Pas njoftimit me titullin e temës mësimore, nxënësve u shpërndani kopje të tekstit "*Letra e Erës*" të ndarë në tri paragrafe dhe e zhvilloni sipas teknikës "*Procedura e të ripyeturit*", (modifikim i teknikës DRTA), p.sh.:

Një nxënës lexon me zë paragrafin e parë: "*Unë dua të të tregoj një ngjarje që më ka ndodhur dy ditë më parë. Po luaja në shtëpi me vëllanë tim. U fsheha prapa bibliotekës. Atje ishte një vazo e madhe. Babi më pa dhe më bërtiti: "Kujdes, mos ta thyesh vazon!".*"

Më pas parashtroni pyetjet, si në vijim:

- Çfarë po bënte personazhi kryesor (Era në shtëpi)?
- Kush e paralajmëroi të ketë kujdes për vazon?
- Si e gjykoni sjelljen e personazhit kryesor (lojën e Erës në shtëpi)?
- A ju lidh me jetën tuaj kjo pjesë që lexuat?
- Çfarë mendimi keni për bërtimat, a ju ndihmojnë që t'iu shmangeni gabimeve?

Për secilën nga këto pyetje, nxënësit japin përgjigjet dhe diskutohet rreth tyre.

Në vazhdim, një nxënës tjetër lexon paragrafin e dytë:

"*Më vonë, unë dola që andej, por vazoja ra dhe u thye. Babi u nxeh dhe më shau shumë. Ka dy ditë, që babi nuk më flet. Mami më tha që vazoja ishte shumë e çmuar. Babi e kishte kujtim nga gjyshi i tij.*"

Pas leximit të këtij paragrafi, nxënësit i shtrojnë pyetje mësuesit/es dhe ai/ajo u përgjigjet atyre.

Pas këtij diskutimi, një nxënës e lexon paragrafin e tretë:

“Kjo më mërziti edhe më shumë. Ju lutem, më thoni diçka për këtë. Unë ndihem shumë keq.”

Pasi lexohet paragrafi i fundit, pyeten nxënësit:

- Si ju bëri të ndjeheni, leximi i pjesës?
- Çfarë mendimi keni për sjelljen e Erës?
- A mendoni që dënimet janë të mira?
- Si ndiheni kur ju shajnë të tjerët?
- A ka vepruar drejt babai i Erës, i cili nuk i foli për kohë të gjatë asaj?
- Si do t’i ndihmonit Erës, për të dalë nga kjo situatë? etj.

Secilit grup të nxënësve, të cilët veç ishin formuar në fillim të orës, do t’u shpërndahet nga një detyrë në pliko, në mënyrë që të reflektojnë për temën e mësuar. Grupet do të udhëzohen:

- të punojnë një “Pesëvargësh”, ku sipas kësaj teknike, nxënësit shkruajnë një emër, dy mbiemra, tri folje, një fjali dhe një sinonim, që lidhet me emrin e Erës;
- të shkruajnë një “Shkrim të lirë”, ku sipas kësaj teknike, nxënësit do ta shkruajnë një ese, që trajton ndonjë situatë problemore;
- të punojnë një poster të thjeshtë;
- ta punojnë “Dorën e pyetjeve”, ku nxënësit e vizatojnë dorën e tyre dhe në secilin gisht vendoset nga një pyetje (Si? Çka? Pse? Kush? Kur?) dhe përgjigjet për to.

Në fund të orës, punimet grupore prezantohen nga një nxënës prej secilit grup, si dhe diskutohen.

Aktivitete shtesë

Aktivitetet shtesë rreth kësaj teme janë të shumta. Ju mund t’i sensibilizoni edhe kolegët në shkollë, në mënyrë që njohja me sjelljet e dhunshme, nga ana e nxënësve të merr përmasa edhe jashtë paraleles ku punoni.

Mund të organizoni kuize diturie me pyetje që përkojnë me këtë teme; të zgjedhni esetë më të mira në tema, që lidhen me dhunën; të organizoni ekspozita me punime me materiale të ndryshme; të trajnohen fëmijët se si t’i identifikojnë sjelljet e dhunshme në shkollë, në familje e gjetiu.

Do të ishte një hap i mirë, që të punoni në mënyrë ekipore (në shkollat, ku ka pedagog, psikolog dhe punëtor social).

KLASA IV

(9-10 VJEÇARËT)

■ **Zhvillimi kognitiv:** Përforcohet konceptimi i identitetit. Fëmijët e përforcojnë të argumentuarit e logjikshëm. Zhvillohen strategji për zgjidhjen e problemeve. Kuptohet dallimi ndërmjet të përgjithshmes dhe të veçantës. Zhvillohet edhe aftësia e konceptimit të kategorive më komplekse. Në këtë moshë, operacioni i kategorizimit tashmë është pjekur. Shkathësitë planifikuese piqen. Të menduarit pavarësohet, si dhe zhvillohen kapacitetet vendimmarrëse.

■ **Zhvillimi emocional:** Fëmijët e kësaj moshe i kuptojnë normat e përgjithshme sociale. Mund ta kontrollojnë zemërimin e tyre. Bëjnë shoqëri solide. Zhvillohet empatia. Arrijnë një lloj stabiliteti emocional. Lirohen nga frika irracionale. Gjithashtu, fillojnë të shfaqin interesim për raportet në çift.

■ **Procesimi i informacionit:** Në këtë moshë fëmijët fillojnë të pavarësohen nga prindërit dhe e kanë shumë të rëndësishme krijimin e shoqërive të reja. Fëmijët në këtë moshë kanë një hapësirë më të gjerë të vëmendjes, e cila u mundëson që të absorbojnë më shumë informata. Presioni nga mos-hatarët është një prej ndryshimeve, që e karakterizon këtë moshë. Por, gjithashtu fillojnë të kuptojnë qasjet e ndryshme dhe janë më të brengosur dhe më të vëmendshëm për mjedisin që i rrethon. Gjë që i shtyen ata në veprime, siç janë ndihma ndaj të tjerëve ose aktivitetet e ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me ndonjë çështje për të cilën ata brengosen.

TEMA: SHKAQET DHE FORMAT E DHUNËS

Kompetencat e synuara

Përmes kësaj teme synohet të arrihen elementet e kompetencave: *Komunikues efektiv, Mendimtar kreativ, Nxënës i suksesshëm, Kontribues produktiv, Individ i shëndoshë dhe Qytetar i përgjegjshëm.* Konkretisht, rezultatet: I. 2, 3; II. 6, 7; III. 1, 2; IV. 5; V. 5, 6; VI. 1, 2, 6, të shkallës së dytë të Kurrikulës Bërthamë (shih KB për klasën parafillore dhe arsimin fillor, f. 25-29).

Qëllimi

Qëllimi i realizimit të kësaj teme është zhvillimi i njohurive të nxënësve për shkaqet e mundshme të dhunës dhe për format e ndryshme të manifestimit të saj në situata jetësore.

Rezultatet e të nxënësve

Gjatë trajtimit të kësaj teme, nxënësit:

- identifikojnë shkaqet e dhunës së situatave të ndryshme;
- diskutojnë për format e dhunës, që janë më evidente në jetën e tyre;
- identifikojnë format paqësore të zgjidhjes së situatave problemore.

PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSVE

Metodologjia e mësimdhënies

Për realizimin e kësaj teme mund të përdoren aktivitetet e ndryshme, të organizuara në formë të lojës, me fokus shkaqet dhe format e dhunës. “Ngjyra më përkujton”, “Shkrimi i rasteve” dhe loja “Ndjenja e përrockës” janë disa nga aktivitetet, që mundësojnë të nxënësve, përmes kreativitetit dhe lojës. Nëse shihet e arsyeshme mund të përdoret edhe ndonjë aktivitet tjetër.

Materialet e nevojshme:

- “Edukata Qytetare 4”, Shtëpia Botuese “Libri Shkollor”, Prishtinë, 2013;
- letra me ngjyrë (lapsa me ngjyrë, nëse nuk keni letra me ngjyrë);
- lapsa;
- fleta të bardha të formatit A4 (fletore), etj.

Koha e nevojshme për zhvillim të temës

Një orë mësimore.

ZHVILLIMI I TEMËS:

Orën mësimore e filloni me aktivitetin “Ngjyra më përkujton”. Ky aktivitet realizohet sipas kësaj procedure:

1. Kërkoni nga nxënësit që të ngrihen në këmbë, të shkojnë në hapësirën më të lirë të klasës dhe të renditen në formë rrethi;
2. Në mesin e zbrazët të rrethit vendosni fleta me ngjyra të ndryshme

(kujdesuni, që të ketë më shumë fleta me ngjyrë të kuqe);

3. Pyetni nxënësit: Çfarë ngjyre u bie ndërmend, kur përmendim “dhunën”;
4. Kërkoni nga nxënësit që ta marrin nga një fletë me ngjyrën që e menduan dhe të kthehen në vendet e tyre;
5. Kur secili nxënës ta ketë marrë letrën me ngjyrë, kërkoni të përgjigjen me radhë duke mbajtur letrën lart dhe duke thënë:

Unë mendoj për ngjyrën _____ kur mendoj për dhunën sepse _____.

Ja dy shembuj të mundshëm të përgjigjeve:

- “Unë mendoj për ngjyrën e verdhë kur mendoj dhunën, sepse shpesh jam i detyruar të shkoj në dhomë dhe ajo dhomë i ka muret e verdha”;
- “Unë mendoj në ngjyrën e zezë kur mendoj për dhunën, sepse ndihem në disponim të errët”.

Më pas, udhëzoni nxënësit që të ulen në grupe (grupet të jenë të kombinuara me nxënës të gjinive dhe intelegjencë të ndryshme).

Prej secilit grup kërkoni të shkruajnë për ndonjë rast dhune (mund të jetë i imagjinuar ose i rrëfyer).

Pas shkrimit të rasteve, grupet i shkëmbejnë rastet e shkruara. Më pas, kërkoni nga nxënësit që anëtarët e njërit grup të diskutojnë rastin e shkruar të grupit tjetër dhe t’u përgjigjen pyetjeve, si në vijim (pyetjet shkruani në dërrasë të zezë):

- Cili është shkaktari i dhunës për rastin në fjalë?
- Çfarë dhune është ushtruar?
- Si do ta kishit zgjidhur rastin në fjalë?
- (Kjo procedurë vlen për të gjitha grupet)

Pas 10 minutash, secili grup prezanton përmbajtjen e rastit dhe përgjigjet në pyetjet e caktuar nga mësuesi, si më lart.

Në pjesën përmblylëse të orës është mirë të zhvilloni një aktivitet çlirues me nxënësit, duke pasur parasysh që në fazat e tjera janë diskutuar çështje të ndjeshme dhe mund të kemi rikthyer çaste të vështira në kokat e tyre. Në këtë rast, zhvilloni aktivitetin “*Ndjendra e përrockës*” sipas kësaj procedure:

1. Kërkoni nga fëmijët t’i shtrëngojnë muskujt në trupin e tyre, derisa t’u themi që t’i lëshojnë;
2. Pas disa sekondash ata të relaksohen ngadalë dhe tërë hidhërimin ta nxjerrin jashtë, duke imagjinuar një përrockë të turbulluar në këmbët e tyre;
3. Përsëritni aktivitetin disa herë dhe pyesni fëmijët se si ndihen;
4. Kur të jenë gati, mund të shkoni një hap më larg, prej përrockës së imagjinuar, duke lënë anash hidhërimin.

Aktivitete shtesë

Aktivitetet shtesë rreth kësaj teme janë të shumta. Mund të gjeni lojëra të ndryshme, të cilat mund t’i aplikoni në orët e fushës Shëndeti dhe mirëqenia, me ç’rast do të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të kompetencave të planifikuara.

KLASA V

(10-11 VJEÇARËT)

■ **Zhvillimi kognitiv:** Në këtë moshë kemi zhvillimin e konservimit të sasisë. Përveç kësaj, fëmijët 10 vjeçarë kanë kapacitetin, që t'i kombinojnë, ndajnë, rendisin dhe t'i transformojnë objektet dhe veprimet. Ata me kompetencë mund ta konservojnë masën dhe hapësirën, madje edhe volumen. Aftësia për ta aplikuar logjikën dhe arsyen është zhvilluar konsiderueshëm, bashkë me të edhe aftësia për ta fokusuar vëmendjen. Mund t'i shikojnë gjërat nga shumë perspektiva.

■ **Zhvillimi emocional:** Gjejnë kënaqësi të vërtetë në raportet shoqërore. Zakonisht, kanë një shok/shoqe shumë të afërt. Fillojnë të bëjnë veprime, të cilat kanë për qëllim tërheqjen e vëmendjes nga personat e gjinisë së kundërt, edhe pse nuk e pranojnë një gjë të tillë. Fillojnë të irritohen herë pas here në raport me prindërit e tyre.

■ **Procesimi i informacionit:** Fëmijët e moshës 10 vjeçare kanë një sens të mirë të orientimit hapësinor dhe kohor. Mund të lexojnë dhe të kuptojnë mirë një paragraf me informacion, madje edhe nëse ai është relativisht kompleks. Fitojnë shkathtësi në mbledhje dhe zbritje, pjesëtim dhe shumëzim, si dhe në pranimin e informacionit të transmetuar në mënyrë verbale. Natyrisht, që kanë ndjesinë ndaj rasteve konfliktuoze dhe mund ta shprehin reagimin ndaj tyre.

Për 10 vjeçarët është shumë e rëndësishme që të kenë marrëdhënie stabile shoqërore e posaçërisht me të njëjtën gjini. Gjatë kësaj periudhe, fëmijët zhvillohen dhe fillojnë të marrin informata nga shumë burime, gjë e cila mund t'i hutojë dhe si pasojë zakonisht ballafaqohen me probleme akademike. Është shumë e rëndësishme, që të punohet me fëmijët në drejtim të krijimit të ndjenjës së përgjegjësisë.

TEMA: ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE NË MËNYRË JO TË DHUNSHME

Kompetencat e synuara

Përmes kësaj teme synohet të arrihen elementet e kompetencave: *Komunikues efektiv, Mendimtar kreativ, Nxënës i suksesshëm, Kontribues produktiv, Individ i shëndoshë, Qytetar i përgjegjshëm*. Konkretisht, rezultatet: I. 1; II. 8; III. 2, 4; IV. 3; V. 2, 6; VI. 3, 6 të shkallës së dytë të Kurrikulës Bërthamë (shih KB për klasën parafillore dhe arsimin fillor, f. 25-29).

Qëllimi

Realizimi i kësaj teme mësimore bëhet me qëllim, që nxënësve t'u zhvillohen njohuritë për "konfliktin" si proces që ndodh në situata të ndryshme në realitetin jetësor dhe shkathësitë që promovojnë shmangien nga konfliktet.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë trajtimit të kësaj teme, nxënësit:

- identifikojnë fjalë të ndryshme që definojnë konfliktin (në organizuesin alfabetik);
- identifikojnë rregullat përkatëse për zgjidhjen e konflikteve;
- demonstronjë teknika të ndryshme për menaxhimin e emocioneve, në raport me zemërimin e tyre.

PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSVE

Metodologjia e mësimdhënies

Realizimi i kësaj ore mësimore bëhet përmes aktiviteteve: *Organizuesit alfabetik, Lidhjes së rregullave për zgjidhjen e konflikteve me situata konfliktuoze dhe Fluskave të ajrit*. Këto aktivitete u ndihmojnë nxënësve ta definojnë konfliktin, t'i identifikojnë rregullat për zgjidhjen e konflikteve dhe t'i menaxhojnë emocionet në raport me konfliktin, respektivisht t'i promovojmë sjelljet e shëndosha, në shmangien dhe tejkalimin e konflikteve, duke tentuar minimizimin e efekteve negative. Nëse e shihni të arsyeshme mund të përdorni aktivitete të tjera për realizimin e kësaj teme mësimore. Gjithashtu, edhe shembujt e situatave konfliktuoze, që trajtohen në këtë manual për këtë temë, mund t'i zëvendësojë me shembuj të tjerë, duke pasur parasysht vendin dhe aktualitetin.

Roli i mësimdhënësve është dominant në zgjidhjen e konfliktit. Mësimdhënësit duhet të jenë model i dëgjueshmërisë së mirë, respektit të ndërsjellë dhe zgjidhjes së drejtë të problemeve.

Materialet e nevojshme:

- kopje të Organizuesit alfabetik (nxënësit mund ta bëjnë edhe në fletore);
- kopje të rregullave dhe të rasteve konfliktuoze (mund t'i shkruani edhe në dërrasë të zeze);
- dërrasa e zeze, markerë (ngjyra të drurit), etj.

Koha e nevojshme për zhvillim të temës

Një orë mësimore.

ZHVILLIMI I TEMËS:

Orën mund ta filloni me “Organizuesin alfabetik”, një ushtrim individual, i cili përdoret për t’i eksploruar mendimet që kanë nxënësit për konfliktin. Ky aktivitet realizohet sipas kësaj procedure:

1. Nxënësve u shpërndani Organizuesin alfabetik, sipas këtij formati:

A	B	C	Ç	D	DH
E	E	F	G	GJ	H
I	J	K	L	LL	M
N	Nj	O	P	Q	R
RR	S	SH	T	TH	U
V	X	XH	Y	Z	ZH

2. Udhëzoni nxënësit që ta titullojnë Organizuesin alfabetik me fjalën “konflikt” dhe këtë ta vendosin mbi tabelën e Organizuesit alfabetik;
3. Në hapësirat ku janë të vendosura shkronjat të shkruhet nga një fjalë që definon fjalën “Konflikt” p.sh.: A-agresion, N-ndryshim, e kështu me radhë.

(Nuk është problem nëse nxënësit nuk gjejnë fjalë për disa shkronja, mjaftojnë 5 minuta që nxënësit të përfundojnë aktivitetin. Nëse fjalët, që kanë përdorur nxënësit në Organizues janë shumica negative, duhet të mundoheni së bashku me ta t’i zëvendësoni me fjalë pozitive).

Pas aktivitetit të Organizuesit alfabetik, secilit nxënës i shpërndani nga një kopje me disa rregulla për zgjidhjen e konflikteve, si më poshtë:

Rregullat për zgjidhjen e konflikteve:

- Dëgjoje dhe palën tjetër ç’thotë;
- Mos i sulmo njerëzit, por shqyrtoje problemin;
- Fyerja nuk ndihmon;
- Ke përgjegjësi për veprimet e tua;
- Çka ishte kaloi - me rëndësi është çka do të bëhet.

Më pas, diskutoni me nxënës për porosinë e secilës rregull, veç e veç, dhe pas këtij diskutimi, nxënësit i ndani në 5 grupe. Secilit grup i shpërndani nga një fletë me një situatë konfliktuoze dhe kërkoni që ta bëjnë lidhjen e situatës me njërën nga rregullat e diskutuara.

Fletët me situata konfliktuoze kanë këto përmbajtje:

Era dhe nëna

Era: Nënë ma jep çokolatën!

Nëna: Nuk halet çokolata para darkës.

Era: Ti vetëm tim vëllai ia jep menjëherë kur e kërkon!!!

(Shembull: situata në fjalë lidhet me rregullën “Dëgjoje edhe palën tjetër ç’thotë”)

Ariani dhe Vesa

Ariani: Ku mbete deri tani? Ka gjysmë ore që të pres.

Vesa: Ç’po bërtet aq shumë? Herën e kaluar ti u vonove më shumë.

(Shembull: situata në fjalë lidhet me rregullën “Çka ishte kaloi - me rëndësi është çka do të bëhet”)

Babi dhe Artani

Babai: Pse nuk e vendose çantën në vendin e vet?

Artani: Mua çdo herë më qorton, kurse Anës (motrës) një fjalë nuk ia thua!

(Shembull: situata në fjalë lidhet me rregullën “Ke përgjegjësi për veprimet e tua”)

Hana dhe Eni

Hana: Pa shihe, shihe! Edhe kjo torrollakja po ditka diçka!

Eni: Në qofsha unë torrollake, atëherë ti çka je?

Hana: Njëqind herë jam më e mirë se ti!

(Shembull: situata në fjalë lidhet me rregullën “Fyerja nuk ndihmon”)

Dielli dhe Ernesti

Dielli: Si e hëngre gjithë ëmbëlsirën duke e ditur se edhe mua më pëlqen?

Ernesti: Ç’faj kam unë që ti nuk ishe në shtëpi!

Dielli: Ti je vetjak!

(Shembull: situata në fjalë lidhet me rregullën “Mos i sulmo njerëzit, por shqyrto problemin”)

Pasi nxënësit në grupe e bëjnë lidhjen e situatës me rregullën përkatëse, atëherë e prezantojnë punën e bërë përmes përfaqësuesit të tyre.

Në pjesën përmbyllëse të orës zhvillon aktivitetin “Ndjenja e fluskave”, sipas kësaj procedure:

1. Nxënësit duhet të qëndrojnë në këmbë në vendin ku ishin ulur;
2. Nxënësve u parashtroni pyetjen: Çka përmbajnë fluskat?;
3. Më pas, merrni disa përgjigje nga nxënësit, p.sh. përgjigja “ajër”, ...;
4. Kërkoni nga nxënësit ta imagjinojnë veten si fluska ajri;
5. Udhëzoni nxënësit që të marrin frymë për dhjetë sekonda, duke imagjinuar diçka që i ka zemëruar (të mbushen me ajër sikurse fluska);
6. Pas dhjetë sekondash nxënësit duhet ngadalë ta lëshojnë frymën jashtë dhe bashkë me të u tregojmë se po e heqim zemërimin.

(Aktiviteti në fjalë është njëra prej teknikave, që ka për qëllim menaxhimin e emocioneve në rast zemërimi, respektivisht parandalimin e konflikteve).

Aktivitete shpesh

Nxënësit mund të punojnë “Posterët paqësorë”, ku do ta paraqesin një aftësi të zgjidhjes së konflikteve.

Një tekst i mundshëm për ta shpjeguar konfliktin mund të jetë në lidhje me dallimet ndërmjet dhunës dhe konfliktit.

(Këto aktivitete mund të realizohen si detyra shtëpie).

KLASA VI

(11-12 VJEÇARËT)

■ **Zhvillimi kognitiv:** Në këtë moshë, fëmijët i kuptojnë ligjet e konservimit, janë në gjendje të klasifikojnë dhe ndajnë ato në seri, si dhe kuptojnë dukurinë e së kundërtës. Po ashtu, janë të aftë t'i zgjidhin problemet në mënyrë logjike, kanë kapacitet më të madh për të mësuar dhe për t'i aplikuar aftësitë që ata/ato i zhvillojnë. Ndërsa, nuk janë në gjendje të mendojnë rreth të menduarit ose për arsye rreth problemeve hipotetike, abstrakte dhe ta përfshijnë koordinimin e menjëhershëm të shumë faktorëve.

■ **Zhvillimi emocional:** Në përgjithësi, fëmijët në fazat e hershme të adoleshencës e fitojnë ndjenjën e tyre të identitetit përmes mënyrës se si ata/ato duken përmes veshjes së tyre, të mirave që ata/ato i kanë, aktiviteteve dhe identifikimit me grupin e bashkëmoshatarëve të tyre. Ata mund të jenë mjaft të vetëdijshëm në publik dhe shpeshherë kalojnë kohë të tepruar për formën e paraqitjes së tyre dhe preokupohen me aspekte të parëndësishme, të dukjes dhe paraqitjes së tyre personale, si ndonjë detaj të vogël ose stil tekanjor të flokëve.

Po ashtu, të rinjtë në moshën e adoleshencës së hershme (11 vjeçare) ballafaqohen me një mjedis më dinamik, duke u zvogëluar nevoja e tyre për t'i udhëhequr dhe orientuar. Në të njëjtën kohë, atyre u rriten kërkesat për njohuri akademike dhe mund edhe të kenë presion nga bashkëmoshatarët e tyre, duke u ballafaquar në të njëjtën kohë me ndryshimet që vijnë nga perioda e adoleshencës.

■ **Procesimi i informacionit:** Fëmijët e kësaj moshe fillojnë ta shohin ndryshe çdo gjë rreth vetes. Prandaj, është mirë të merret parasysh çdo gjë që ata/ato i preukopon. Mbi këto baza, ata shprehin interesim që situatat të shihen sa më drejt dhe qartë. Ata janë në gjendje t'i hulumtojnë shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve, që janë të lidhura me dhunën, si dhe të involvohen në zgjidhjen e tyre përmes komunikimit, rasteve të dëgjua, të para, ose organizimeve të ndryshme. Fëmijët e kësaj moshe kanë nevojë të ndjehen të sigurt. Ata/ato tentojnë vetë ta kërkojnë këtë siguri, prandaj është shumë e rëndësishme të dinë t'i qasen kësaj kërkesë: me dhunë a me kompromis! Kërkesat e tilla i bëjnë ata të aftë, të jenë vendimmarrës për gjendjet e tyre, të tjerëve, si dhe të tërë shoqërisë. Ata/ato janë në gjendje t'i shprehin mendimet e veta përmes pyetjeve, simboleve, si dhe të japin argumente bindëse dhe të reflektojnë për to.

TEMA: KOMUNIKIMI SI MËNYRË E TEJKALIMIT TË PROBLEMEVE

Kompetencat e synuara

Përmes kësaj teme synohet të arrihen elementet e kompetencave: *Komunikues efektiv, Mendimtar kreativ, Nxënës i suksesshëm, Individ i shëndoshë, Qytetar i përgjegjshëm*. Konkretisht, rezultatet: I. 3, 8; II. 2, 8; III. 3, 5; IV. 1, 3, 6, 7; V. 6; VI. 1, 2, 4, të shkallës së tretë të Kurrikulës Bërthamë (shih KB e arsimit të mesëm të ulët, f. 19-22).

Qëllimi

Qëllimi i realizimit të kësaj teme është vetëdijësimi i nxënësve për rëndësinë e zhvillimit të kulturës së komunikimit, si qasje që ndihmon në parandalimin dhe tejkalimin e situatave problemore (konfliktuozë).

Rezultatet e të nxënësve

Gjatë trajtimit të kësaj teme, nxënësit:

- identifikojnë format e komunikimit, si mjete për parandalim dhe zgjidhje të situatave problemore (konfliktuozë);
- trajtojnë ngjarjen (tregimin) e përzgjedhur për debat, nga perspektiva të ndryshme, duke shfrytëzuar të dhënat në dispozicion;
- demonstrojnë respekt, tolerancë në mendime, barazi dhe gjykim të drejtë gjatë debatimit të ngjarjes së përzgjedhur.

PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSVE

Metodologjia e mësimit

Për realizimin e kësaj teme konsiderojmë se debati është një strategji mjaft e përshatshme. Përmes debatit, jo vetëm që trajtohet ana teorike e komunikimit, si faktor mjaft i rëndësishëm në tejkalimin e situatave problemore, por në këtë rast ushtrohen edhe shkathësitë e komunikimit në funksion të trajtimit të situatave problemore.

Debati zhvillohet me ndarjen e nxënësve në tri grupe, të cilat ndahen sipas asaj se a e kanë kuptuar apo jo porosinë e tregimit, si dhe ka për qëllim nxitjen e debatit:

■ **Grupi I:** mbledh nxënësit që mendojnë se e kanë të qartë idenë dhe porosinë e tregimit;

■ **Grupi II:** mbledh nxënësit që mendojnë se nuk e kanë të qartë idenë dhe porosinë e tregimit;

■ **Grupi III:** mbledh nxënësit që shtrojnë pyetje për grupet I dhe II. Një nxënës nga ky grup i shënon përgjigjet e dy grupeve debatuere.

Grupet I, II nën udhëheqjen e mësimitdhënësit/ses dhe grupit III, përplas argumentet dhe qëndrimet e veta rreth personazheve dhe ngjarjes. Argumentet e pranuar nga të gjithë, konsiderohen si konkluzione rreth asaj se cila është porosia e tregimit. Debatin mund ta zhvillojë në dhomë të madhe mësimi (klasë), mund të jetë korridori, salla e edukatës fizike ose oborri i shkollës, në mënyrë që nxënësve t'u krijohet hapësirë për të lëvizur.

Materialet e nevojshme:

Për realizimin e debatit mund të përdorni materiale të ndryshme që keni në dispozicion, si:

- pajisje zërimi nëse shkolla ka, por jo domosdoshmërisht;
- tregim/ngjarje e zgjedhur nga mësimdhënësi/ja, që mund të merret nga burime të ndryshme: libra, internet, media elektronike dhe të shkruara. (Tregimi duhet të jetë i kopjuar për numër të nxënësve. Gjuha e shkrimit të tregimit duhet të jetë e përshtatshme me moshën e nxënësve);
- mund të jetë edhe ngjarje e rrëfyer, qoftë nga mësuesi ose nga ndonjë nxënës. (Derisa mësuesi/nxënësi rrëfen, nxënësit e tjerë mund ta shkruajnë në fletore);
- lapsa, letër dhe tabelë shfletuese ose mund ta shfrytëzoni dërrasën e zezë.

Për t'i shtuar debatit efektin dhe rëndësinë mund ta ftoni për pjesëmarrje edhe një psikolog të shkollës, nëse shkolla ka. Psikologu duhet të jetë në rolin e vëzhguesit, eventualisht mund t'i ndihmojë nxënësit në ndonjë pjesë të debatit.

Koha e nevojshme për zhvillimin e temës

Një orë mësimi.

ZHVILLIMI I TEMËS

Në fillim, nxënësit duhet të njihen me temën që do të trajtohet, pastaj u shpërndahet tregimi i përzgjedhur, që të lexohet për 5 deri

10 minuta. (Duhet pasur kujdes që të gjithë nxënësit ta kenë nga një kopje të tregimit).

Pasi nxënësit njihen me përmbajtjen e tregimit, njoftohen se do të zhvillojnë debat rreth tregimit të lexuar dhe bashkërisht vendosin për rregullat e debatit. Rregullat e debatit mësimdhënësi/ja ose ndonjë nxënës i shkruan në dërrasë të zezë, ose tabelë shfletuese (nëse shkolla ka kushte mund të shkruhen në kompjuter, që është i lidhur me projektor ose tabelë elektronike).

Rregullat mund të jenë:

- të gjithë nxënësit të përfshihen në debat;
- të flitet me rend;
- asnjëri nuk duhet ta ndërpresë tjetrin, derisa ta mbarojë fjalën;
- të respektohet diversiteti i mendimeve të shfaqura, etj.

Pas caktimit të rregullave, mund të kërkoni nga të gjithë nxënësit ta thonë më zë të lartë titullin e temës së lexuar. Më pas, kërkoni nga nxënësit që e kanë kuptuar porosinë e tregimit ta ngrisin dorën e djathtë, dhe ata që nuk e kanë kuptuar ta ngrisin dorën e majtë, kurse ata që kanë për të bërë pyetje të mos i ngrisin duart fare. Kështu, mbi këtë bazë, ata ndahen në dy grupe debatuese dhe një grup nxitës (shih më lartë metodologjinë e mësimdhënies).

Debati fillon me Grupin III, i cili u shteron pyetje Grupeve I dhe II, për t'i nxjerrë mendimet e tyre rreth përmbajtjes, idesë dhe porosisë së tregimit. Gjatë debatit, nxënësi i përzgjedhur për mbajtjen e shënimeve nga Grupi III, i shkruan në dërrasë të zezë (tabelë shfletuese ose kompjuter të lidhur me projektor) të gjitha përgjigjet e të dy grupeve debatuese. Pas zhvillimit të debatit, ky nxënës rikujton përgjigjet e dhëna nga grupet debat-

uese, duke i lexuar ato me qëllim të përafrimit të mendimeve, sa i përket kuptimit të porosisë së tregimit.

Në fund, i udhëzoni të gjithë nxënësit ta nxjerrin porosinë e përbashkët për komunikim me anë të teknikës “Pesëvargësh” p.sh.:

Kërkoni nga nxënësit të identifikojnë:

1. një emër që ka të bëjë me komunikimin (p.sh. Debat);
2. dy mbiemra që lidhen me komunikimin (p.sh. i drejtë, i rëndësishëm);
3. tri folje që tregojnë veprimet kryesore (p.sh. parandalon, zgjidh, qetëson);
4. një fjali lidhur me komunikimin, mundësisht të shkurtër (p.sh. Debati është i rëndësishëm për parandalimin e konfliktit);
5. një sinonim që lidhet me komunikimin (dialog).

(Të gjitha këto ju si mësimdhënës i shkruan në dërrasë të zezë).

Aktivite shtesë

Aktivitetet e shumta që mund të realizohen brenda dhe jashtë shkollave, janë shumë të vlefshme dhe shërbejnë në orientimin e mirë të nxënësve, sipas interesimeve dhe talentit të tyre. Angazhimi i nxënësve në larushi të programeve, gjithmonë sipas zgjedhjes së tyre (aktivite kulturore – artistike, si: orë letrare, figurative, muzikore, teatrale, sportive etj.), i ndihmon ata në shfrytëzimin për të mirë të energjive të reja dhe herë-herë të tepërta, si dhe në ndërtimin e relacioneve të shëndosha ndërmjet nxënësve dhe personelit tjetër të shkollës. Kështu, me komunikimin artistik dhe kulturor nxënësit bëhen kreativ, përgjegjës, fleksibil, me vetëbesim, tolerantë dhe të aftë për ta kuptuar çdo rrethanë dhe për t'i ndihmuar tejkalimit të problemeve të ndryshme.

KLASA VII

(12-13 VJEÇARËT)

Zhvillimi kognitiv: Në këtë moshë fillon faza e zhvillimit të të menduarit operacional formal. Gjatë kësaj moshe, fëmijët përjetojnë pozitivisht mundësinë për të marrë më shumë vendime për veten e tyre dhe për të marrë përgjegjësi shtesë, të cilat ua fuqizojnë ndjenjën e arritjes së moshës madhore. Atyre u pëlqen t'i shfaqin aftësitë dhe talentet e tyre dhe shpeshherë përfshihen, në mënyrë intensive, në aktivitete argëtuese dhe aktivitete të lira, të cilat i theksojnë pasionet e tyre. Të menduarit fillon të bëhet më i logjikshëm dhe janë në gjendje të manipulojnë me koncepte hipotetike, si: mundësia për t'i paramenduar rezultatet e ndryshme, të mundshme, në rrethana të veçanta.

Zhvillimi emocional: Fëmijët fillojnë të tregojnë shenja më të mëdha të zhvillimit të durimit dhe aftësive për të toleruar frustrimin dhe vonesën në marrjen e asaj që ata duan. Në të njëjtën kohë, ata mund të jenë më përgjegjës për impulset/reagimet e papritura, gjykimet e varfra, në raste të caktuara, argumentimin dhe sfidimin e opinioneve të marra. Mospërputhje të tilla janë pjesë përbërëse e sfidës së zhvillimit të identitetit të pavarur.

Fëmijët në këtë moshë fillojnë të bëhen më pak të varur emocionalisht nga prindërit dhe më të aftë për të menduar dhe vepruar në mënyrë të pavarur. Po ashtu, fillojnë të marrin dhe t'i ndjekin vendimet e tyre, t'i zhvillojnë parimet e tyre morale, në mënyrë që të bëhen të aftë si të rritur të vetë-mjaftueshëm. Edhe pse, ende do të ndikohen nga vlerat dhe udhëzimet e prindërve të tyre, dëshirojnë që të lidhen më shumë me miqtë sesa me familjen.

Procesimi i informacionit: Fëmijët e moshës 12, 13 vjeçare kanë ndërveprime më të kontrolluara dhe jo aq euforike sa moshat e mëhershme. Tani, ata kanë koncepte më të qarta dhe çështjet i adresojnë pa nguti. Përpunimi i informacioneve është më i plotë dhe më i kontrolluar, si dhe kanë kapacitet më shumë për ta njohur identitetin e vet, duke ndërtuar stilin e vet të sjelljeve dhe të veshjes. Fëmijët e kësaj moshe janë në gjendje, në mënyrë më të matur dhe të organizuar, të reagojnë dhe të marrin iniciativa për raste të shkeljeve dhe të diskriminimit, me hapa konkretë dhe kanë durim të presin rezultate. Përderisa, rastet diskriminuese i "luftojnë" në një farë mënyre, kurse për raste të paragjykimëve sikur ende nuk tregojnë aq interesim për t'i mënjanuar dhe shpesh u besojnë atyre, si dhe nuk përpiqen të bëjnë dallimin midis asaj se kur paragjykimet janë pozitive dhe kur janë negative. Kjo ndodhë, mbase mosha e tyre kërkon që domosdoshmërisht të arrihen synimet e dëshiruara.

TEMA: PARAGJYKIMI DHE DISKRIMINIMI

Kompetencat e synuara

Përmes kësaj teme synohet të arrihen rezultatet e kompetencave: I. 2, 3, 6, 7; II. 1, 6, 7, 8; III. 1, 5, 6, 7; IV. 1, 4, 7; V. 6; VI. 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8. Tema e cila do të elaborohet prek të gjitha kompetencat dhe çon drejt arritjes së rezultateve, që nxënësi të jetë: *Komunikues efektiv, Mendimtar kreativ, Nxënës i suksesshëm, Kontribues produktiv, Individ i shëndoshë, dhe Qytetar i përgjegjshëm.* (shih KB e arsimit të mesëm të ulët f. 19-22, shkalla e tretë kurrikulare).

Qëllimi

Kjo temë realizohet me qëllim që nxënësit të arrijnë të kuptojnë ç'janë diskriminimi dhe paragjykimi, si dhe çfarë efektesh negative kanë për individin dhe shoqërinë.

Rezultatet e të nxënësve

Nëpërmjet trajtimit të kësaj teme, nxënësit:

- dallojnë format e diskriminimit, kur ai është i tërthortë ose i drejtpërdrejtë;
- dallojnë natyrën e paragjykimeve në situata të ndryshme;
- identifikojnë mekanizmat, ligjet vendore dhe instrumentet ndërkom-bëtare, që garantojnë mbrojtjen e çdo individi nga paragjykimet dhe diskriminimi.

PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSVE

Metodologjia e mësimdhënies

Realizimi i kësaj teme mësimore bëhet përmes teknikave: “*Stuhi mendimesh*”, “*Rrjeti i diskutimit*”, “*Ditari dypjesësh*” dhe punës në grupe si formë pune, përmes së cilës anazhohen bashkërisht për punën e përbashkët, e në këtë rast, për analizën e dokumentacioneve që ndalojnë paragjykimet dhe diskriminimet.

Me teknikën “*Stuhi mendimesh*” fillohet ora mësimore, duke marrë idetë fillestare të nxënësve rreth aspekteve të paragjykimit dhe diskriminimit. Ndërkaq, me teknikën “*Ditari dypjesësh*” arrihet thellimi në temë dhe nxjerrja e konkluzioneve të duhura.

Me qëllim të arritjes së nivelit të duhur të informacioneve mbi legjislacionin dhe praktikën e përbashkët me rastet e paragjykimeve dhe të diskriminimeve, mund ta ftoni në klasë një mysafir me përvojë nga institucionet e ndryshme qeveritare ose joqeveritare.

Gjithashtu, mund të përdoren teknika të ndryshme nga këto të përzgjedhurat për trajtimin e temës mësimore, nëse e shihni të arsyeshme.

Materialet e nevojshme:

Për ta realizuar këtë temë brenda një ore mësimore, paraprakisht duhet të sigurohen materialet nga ana e mësimdhënësit/ses, por pse jo edhe nga vetë nxënësit, të cilët mund të hulumtojnë burime të ndryshme informacioni. Materialet mund të jenë:

- Konventa e të Drejtave të Fëmijës;
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- Libri i Edukatës Qytetare;
- gazeta ditore të ndryshme;
- libra të tjerë;

- letër;
- laps;
- marker;
- tabelë shfletuese, etj.

Koha e nevojshme për zhvillim të temës

Një orë mësimi, me mundësi vazhdimi.

ZHVILLIMI I TEMËS:

Në fillim duhet ta nxisni interesimin te nxënësit nëpërmjet dy-tri pyetjeve fillestare, si p.sh. *A e kuptoni nocionin diskrimin? Çka mendoni se është paragjykimi? A mund të jepni shembuj të diskriminimeve dhe paragjykimeve? Më pas, merren përgjigjet e nxënësve, duke realizuar teknikën “Stuhi mendimesh”, që është mjaft e vlefshme për krijimin e një pasqyre të informacionit, se çfarë dinë dhe çfarë duhet të dinë nxënësit, në lidhje me temën që zhvillohet.*

Më tej, i organizoni nxënësit nëpër grupe dhe gjithë materialin që keni e vendosni diku në një vend, ku nxënësit të kenë mundësi të shërbehen për nevojat e detyrave, që u jepen gjatë orës. (Konventa e të Drejtave të Fëmijës, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Edukata Qytetare 7 - nëse janë konventat, gazeta ditore të ndryshme - nëse trajtohen konventat).

Pastaj, për rrjedhën e orës, i udhëzoni nxënësit në grupe për ta shqyrtuar përmbajtjen e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës, si:

1. Grupi I dhe II analizojnë parimet e këtyre instrumenteve ndërkombëtare; ndërkaq,
2. Grupi III dhe IV identifikojnë nenet që garantojnë mosdiskriminimin, e që

natyrisht edhe kërkojnë tejkalimin e çdo lloj paragjykimi.

Pas punës në grupe, realizoni teknikën “Rrjet diskutimi”, duke i marrë përgjigjet e nxënësve karshi pyetjeve, si në vijim:

1. Cilat janë parimet bazë të këtyre instrumenteve ndërkombëtare?
2. Gjetët ndonjë nen që ndalon diskriminimin?
3. Sa janë të dëmshme elementet diskriminuese?
4. Cilat kategori njerëzish diskriminohen me shumë?
5. Sa janë të dëmshme paragjykimet?
6. Sa janë të pranishme këto trajtime te ne? etj.

Pas pyetjeve dhe përgjigjeve, nxënësit tashmë duhet ta kenë edhe më shumë të qartë se rastet diskriminuese dhe paragjykimet janë jashtëzakonisht të dëmshme për ta dhe për gjithë shoqërinë. Mos harroni se gjatë gjithë kohës edhe mysafiri special merr pjesë në aktivitetin me nxënës dhe jep plotësime e sugjerime, nëse nxënësit kanë nevojë.

Në fund të kësaj ore mësimore udhëzoni nxënësit që sipas teknikës “Ditari dypjesësh” ta ndajnë me një vizë dërrasën e zezë ose tabelën shfletuese, në mënyrë që t’i nxjerrin/shkruajnë shkaqet në një rën anë dhe pasojat në anën tjetër. Përsa i përket diskriminimit dhe paragjykimeve, shih tabelën më poshtë. Ju si mësimdhënës/e merrni nismën duke e plotësuar shtyllën e parë, pastaj nxënësit vazhdojnë më tej...

Kushtet e rënda ekonomike	Analfabetizmi, papunësia, varfëria, pozita jo mirë e femrës në shoqëri, fëmijët e zonave rurale, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët nga komunitetet e ndryshme, etj.

Kështu, nxënësit i procesojnë informacionet e tyre mbi problemet shoqërore, duke hulumtuar dhe pas diskutimeve për to, arrijnë t'i gjejnë mekanizmat mbrojtës dhe të shohin edhe rolin e vet në parandalimin dhe luftimin e diskriminimit mbi çfarëdo baze. Lirimi nga paragjykimet paraqet një rëndësi të veçantë për lirim nga ndjenjat negative që përcillen me antipati.

mund t'u sugjerohet organeve të shkollës mbajtja e seminareve, e trajnimeve, me qëllim të sensibilizimit të komunitetit shkollor për rolin në parandalimin e diskriminimit, paragjykimëve dhe stigmatizimeve të ndryshme.

Aktivitete shtesë

Nxënësit bashkë me mësimdhënësin/en mund të përgatisin edhe forma të anketimit dhe të zhvillimit të pyetësorëve për mësimdhënësin, nxënësin dhe prindërit. Rrjedhimisht, tema të jetë e lidhur me diskriminimin në shkollë ose në komunitet. Për këtë gjë, u duhet ndihmë dhe përkrahje nga jashtë. Por, gjithsesi, realizimi duhet të bëhet në konsultim me autoritetet e tjera shkollore, si: drejtor, mësimdhënësin, psikolog, etj. Gjithashtu, duhet të respektohen kushtet e anonimitetit të realizimit të intervistave dhe pyetësorëve. Anonimiteti do të ndihmonte t'i shmangemi reagimeve dhe personalizimit të rasteve dhe çështjeve të caktuara. Realizimi i anketimit do t'i bënte nxënësit kreativë, të përgjegjshëm dhe të shkathhtë për identifikimin e problemeve, nxjerrjen e rezultateve dhe rekomandimeve që çojnë në zgjidhjet e duhura. Më tej, pas raportit me rekomandime, mbi atë bazë

KLASA VIII

(13-14 VJEÇARËT)

■ **Zhvillimi kognitiv:** Moshë 13 vjeçare karakterizohet me adoleshencën e mesme, që ndryshe njihet si kohë e ndryshimeve rapide. Të menduarit operacional formal dhe arsytimi abstrakt janë më të theksuar. Po ashtu, janë të aftë të kuptojnë shkallët e intensitetit të ndonjë veprimi, luftojnë me konceptet abstrakte të dashurisë dhe drejtësisë, formulojnë vlera, duke u bazuar në analizim dhe mendim, e jo vetëm duke u bazuar në përjetim dhe ndjenja. Përgjithësisht, mund t'i kontrollojnë disa faktorë të ndryshëm dhe të veprojnë duke menduar një varg mundësish si zgjidhje.

Zhvillimi mendor shënon rënie, gjatë viteve të adoleshencës, andaj sugjerohet që në këtë periudhë të mësohen më pak aftësi të reja, sepse fëmijët integrojnë më shumë ato që tanimë i kanë mësuar. Gjatë kësaj periudhe, sistemi i kërkimit të kënaqësisë dhe sistemi i rregullimit të impulseve / reagimeve fillojnë të bashkëpunojnë, dhe kështu t'i koordinojnë më mirë mendimet dhe ndjenjat, duke mundësuar një kontroll afatgjatë dhe më të mirë të impulseve/reagimeve.

■ **Zhvillimi emocional:** Në këtë moshë, gjithnjë e më shumë fëmijët fillojnë të bëhen më të pavarur nga familja e tyre. Përderisa, kanë më shumë nevojë për të mbetur vetëm, veçanërisht në shtëpi. Bëhen të ndjeshëm, andaj ndjenjat e tyre mund të lëndohen me lehtësi. Gjithashtu, ata me lehtësi mund t'i lëndojnë ndjenjat e të tjerëve. Janë të varur dhe të shqetësuar në raport me shoqërinë, tregojnë afërsi në marrëdhënie me gjininë e kundërt, ndërsa shoqëria me gjininë e njëjtë vazhdon të dominojë. Rritet ndikimi i presionit nga bashkëmoshatarët, kështu mund të ndikohen rreth përzgjedhjes së veshjeve, shijeve muzikore, mënyrës së të shprehurit dhe përpjekjeve që të jenë sa më të pranueshëm.

■ **Procesimi i informacionit:** Te fëmijët e moshës 14-15 vjeçare procesimi i informacioneve është mjaft kompleks, sepse ndikojnë shumë faktorë. Disa nga ato që vlerësohen si më të rëndësishmet dhe më evidente, gjatë kësaj moshe, janë: ndryshimet trupore-fiziologjike dhe ndryshimet psikologjike e sociale, që do të thotë se disa fëmijë preken nga dy fazat e zhvillimit: ajo e pubertetit dhe adoleshencës. Në përgjithësi, te ata zhvillohet të menduarit kritik dhe përqendrimi ose shpërqendrimi rritet. Për këtë arsye, ata bëhen më kërkues, sidomos në pranimin e informacioneve dhe ndjejnë nevojën për mbikëqyrje. Përndryshe, fëmijët e kësaj moshe janë në gjendje të kryejnë veprime befasuese për të mirë. Prandaj, është shumë e nevojshme që të angazhohen të gjitha subjektet sociale, arsimore dhe politike, që fëmijët e kësaj moshe të trajtohen sa më mirë dhe të angazhohen sa më shumë me detyra dhe përgjegjësi, në mënyrë që kapacitetet e tyre të drejtohen drejt vlerave dhe qëndrimeve të frytshme, si: respekti për vete, respekti për të tjerët, gjykimi i drejtë, krijimi i modeleve, barazia, toleranca, etj. Ata/ato janë në gjendje të marrin vendime dhe janë të aftë edhe të gjykojnë.

TEMA: LLOJET E DHUNËS DHE RAPORTIMI

Kompetencat e synuara:

Përmes kësaj teme synohet të arrihen elementet e kompetencave: *Komunikues efektiv, Mendimtar kreativ, Nxënës i suksesshëm, Kontribues produktiv, Individ i shëndoshë, Qytetar i përgjegjshëm*. Konkretisht, rezultatet: I. 8; II. I; III. 3, 5, 8; IV. I, 5; V. 6, 7; VI. 2, 3, 4, 5, 7, 8 të shkallës së katërt të Kurrikulës Bërthamë (shih KB e arsimit të mesëm të ulët, f. 19-22).

Qëllimi

Qëllimi i realizimit të një a më shumë aktiviteteve mësimore me këtë temë është që të nxënësit të zgjerohen njohuritë për llojet e dhunës, format e raportimit, për mekanizmat, dhe institucionet përgjegjëse, që kanë të bëjnë me parandalimin, referimin dhe trajtimin efikas të rasteve të dhunës.

Rezultatet e të nxënësve

Nëpërmjet trajtimit të kësaj teme, nxënësit:

- dallojnë format e dhunës që manifestohen në situata jetësore;
- identifikojnë institucionet dhe mekanizmat përgjegjës, ku raportohet dhe referohet dhuna, në vendbanimet, ku ata jetojnë;
- krijojnë instrumente që janë në funksion të parandalimit të dhunës (si kartuçet)

PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSVE

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi/ja, paraprakisht duhet të njoftohet me institucionet dhe organizatat që merren me çështjet e dhunës në lokacionin e komunës, në të cilën gjendet shkolla. Diskutimi me nxënës, prindër, arsimtarë, si dhe me profesionistë të fushës, e pasuron edhe më shumë përgatitjen e mësimdhënësit për orën mësimore dhe aktivitetet shtesë.

Ora mësimore, me këtë temë, mund të fillojë me teknikën “Stuhi mendimesh”, ku merren opinionet e nxënësve, se çfarë dinë për dhunën dhe format e saj. Pastaj, nën tingujt e një melodie instrumentale (lëshuar në CD) lexohet teksti i përzgjedhur për zhvillimin e temës, ku të gjithë nxënësit e dëgjojnë dhe më pas inkuadrohen me shënime dhe komente të çështjeve relevante. Gjithashtu, përdoret aktiviteti “vizato zemrën”, përmes së cilit nxënësin bëhen vetë-kritikë për veprimet e bëra. Ora mësimore përfundon me përgatitjen e kartuçeve, përmes të cilëve vie në shprehje kreativiteti i nxënësve dhe kontributi i tyre në parandalimin e dhunës.

Materialet e nevojshme:

Për trajtimin e kësaj teme brenda një ore mësimore mund të përdoren materiale të ndryshme, si:

- ndonjë tregim a ngjarje marrë nga libri i Edukatës Qytetare;
- libri i Gjuhës Amtare;
- libra të tjerë;
- artikuj që trajtojnë ngjarje të dhunës;
- deklaratat nga persona të komunitetit (dëshmitarë të ndonjë situatë të caktuar);
- materiale harxhuese, si: markerë, shkumës, CD, letër, laps, etj.

Koha e nevojshme për zhvillim të temës

Një orë mësimore dhe orë shtesë sipas nevojës dhe interesimeve.

ZHVILLIMI I TEMËS:

Në fillim, njoftoni nxënësit me temën që do të trajtohet dhe u kërkoni që ta shfletojnë gjithë materialin që kanë për temën (p.sh. librin e Edukatës Qytetare, ndonjë tregim në librin e Gjuhës Amtare, kujtoni materialet e nevojshme). Pastaj, ju si mësimdhënës/e shënoni në dërrasë të zezë disa pyetje, si:

- Ç'dini për dhunën?
- Çfarë mund të jetë ajo?
- *Kush duhet t'i mbështes viktimat e dhunës?*
- *Ku duhet t'i adresojmë rastet e dhunës?*
- *Cilat institucione merren me parandalim dhe reagim ndaj dhunës?*
- *A ka raste të dhunës në klasë, shkollë, komunitet?*
- *Po në familje? etj.*

Kështu, përdorni teknikën “*Stuhi mendimesh*”, ndërkohë që nxënësit i shkruajnë përgjigjet në fletoret e tyre. Pastaj, me marrëveshje, zhvilloni një teknikë “*Stilolapsi në mes*”, ku duhet t'i grumbulloni lapsat e nxënësve dhe symbyllur të merrni një. Kjo bëhet me qëllim që përzgjedhja e nxënësve, që do të përgjigjen, të bëhet pa ndonjë anim a preferencë.

Më tej, bashkërisht me nxënësit bëni përzgjedhjen e materialit, që veç është shfletuar në fillim të orës. Ky material të përdoret për elaborim të mëtejshëm të temës mësimore (materiali që përzgjedhet, mundësisht të jetë tregim, në të cilin trajtohet dhuna). Pas përzgjedhjes së tregimit, u sugjeroni nxënësve t'i mbështesin kokat mbi bankë, sikur duan të flenë, kuptohet në kushte klase. Kjo gjë,

nxënësve mund t'u duket paksa argëtuese, por situata fillon të bëhet serioze kur dëgjohej një melodi instrumentale, e bashkë me të edhe leximi i tekstit të përzgjedhur. Kuptohet, melodia duhet të jetë klasike, e përshtatur me tematikën e tregimit. (Nëse në shkollë nuk ka mundësi të dëgjohej muzika, atëherë nxënësit mund të qëndrojnë me kokat mbi bankë dhe të dëgjojnë tregimin, që ju e lexoni).

Kjo formë e punës u ndihmon fëmijëve ta drejtojnë imaginatën, secili sipas mënyrës së vetë. Kur të përfundojë një gjendje e tillë, sigurisht shumë emocionale, e ndikuar nga tregimi, nxënësit në disa fletë (fletore) vizatojnë nga një zemër. Brenda zemrës ata duhet të shkruajnë pyetjen: *Si do të doja të më trajtojnë të tjerët?* Ndërsa, jashtë zemrës së vizatuar shkruajnë: *Si nuk do të doja të më trajtojnë të tjerët?* Dhe, më pas, shkruajnë edhe përgjigjet. Kjo gjë do t'u ndihmojë nxënësve, që rastet e tilla të dhunshme të provojnë t'i zgjidhin, duke u nisur së pari nga vetvetja. Ata duhet të mëndojnë se mos kanë ushtruar dhunë mbi dikë, ose është ushtruar dhunë mbi ta, për çka nuk kanë qenë të vetëdijshëm.

Kur të shihni se nxënësit e kanë kuptuar thelbin e temës dhe pasi, shpesh gjatë orës mësimore janë dëgjuar pohimet dhe mohimet, atëherë bashkërisht përgatisni disa kartuçë (ose në fletë të vizatimit) për parandalimin e dhunës me ngjyrë, me porosi, si:

- Dhuna vret!
- Stop dhunës!
- Mos lëndoni!

Gjithashtu, u thoni nxënësve që mbrapa kartuçëve (fletës së vizatimit) të shkruajnë edhe institucionet se ku mund të raportohet dhuna. Në fund, bashkë me nxënësit vendosni, që këto kartuçë të shpërndahen në komunitetin ku vepron shkolla (në familje dhe rrethin ku jetojnë).

Aktivite shtesë

Edhe për këtë temë janë relevante aktivitetet e shumta ekstrakurrikulare me pjesëmarrje të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore dhe organizatave joqeveritare. Aktivitetet mund të kenë karakter garues, ku nxënësit stimulohen me çmime dhe mirënjohje, por edhe karakter debati, konference, hulumtimi ose programi artistik, me pika të larmishme etj., ku gjithsesi çmohet dhe vlerësohet përpjekja e nxënësve dhe mësimeve për parandalimin, referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në shkollë, duke i kontribuar edhe parandalimit të dhunës në nivele të tjera. Pjesë integrale e secilit aktivitet duhet të jetë edhe identifikimi dhe përdorimi i instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut/fëmijëve, që përveç tjerash garantojnë edhe mbrojtjen nga dhuna.

KLASA IX

(14-15 VJEÇARËT)

■ **Zhvillimi kognitiv:** Fëmijët në këtë moshë, zakonisht përqendrohen në të tashmen, mirëpo ata fillojnë të kuptojnë se atë çfarë bëjnë tani mund të kenë efekte afatgjata. Gjatë kësaj moshe përsosën aftësitë operationale formale, të menduarit fillon të bëhet më shkencor dhe përqendrimi i të menduarit rritet.

Ata, gjithashtu fillojnë të kuptojnë se çështjet nuk janë aq të qarta dhe se informacioni mund të interpretohet në mënyra të ndryshme. Kështu, përforcohen aftësitë argumentuese dhe të menduarit në mënyrë më komplekse rritet. Në këtë moshë ndodhin ndryshime të njëpasnjëshme, si fizike, mendore, emocionale dhe sociale, të cilat rrjedhin më shumë si pasojë e procesit të zhvillimit sesa të moshës.

■ **Zhvillimi emocional:** Në ndërkohë, që ata kalojnë nga fëmijëria në moshën e rritur, adoleshentët ndjejnë nevojën që të jenë më të pavarur nga familjet e tyre. Shpesh miqtë zëvendësojnë prindërit si burim i këshillimit, por prapëseprapë, mbështetja familjare është e rëndësishme që t'i ndihmojë ata për të krijuar një ndjenjë të fortë mbi vetveten. Ata bëhen më të pavarur, kanë personalitetin dhe interesimet e tyre, ndonëse në ndërdije prindërit janë ende shumë të rëndësishëm. Gjatë kësaj kohe, shkathtësitë e të menduarit marrin një orientim të fuqishëm drejt të rriturit, trupi i tyre piqet, ndërsa miqtë dhe rrjetet sociale jashtë familjes bëhen gjithnjë e më të rëndësishme.

Gjithashtu, në këtë moshë adoleshentët janë përgjithësisht të lumtur dhe bashkëpunues të mirë. U pëlqen të kenë shumë punë dhe të përfshihen në aktivitete shtesë. I njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta, formojnë rreth shoqëror të gjerë, përfshirë miqtë nga të dy gjinitë, përderisa interesimi për gjininë e kundërt është shumë i madh.

Është shumë e rëndësishme, që të pëlqehen nga të tjerët dhe në vazhdimësi përballen me presionin e moshatarëve.

■ **Procesimi i informacionit:** Gjeneratat e reja, përkatësisht mosha 13/14 vjeçare, e marrin me entuziazëm çdo lloj nisme kur është fjala për dhunën. Ata janë në gjendje t'i njohin, t'i kuptojnë, dhe janë të shkathtë për marrjen e iniciativave të tilla për parandalim e formave të ndryshme të dhunës. Fëmijët e kësaj moshe janë shumë të interesuar të shpjegojnë ngjarje që i kanë parë ose dëgjuar, lexuar në libra, parë filma me tematikë dhune në TV ose edhe raste dhune nga jeta e përditshme. Kjo moshë i bënë ata të aftë të japin kritika dhe të mos pajtohen me qëndrime të tilla të dëmshme për veten dhe shoqërinë. Synojnë të marrin vendime dhe janë të gatshëm të ndihmojnë në veprime, si: mbledhjen e sondazheve për ushtrim dhune në shkollë ose edhe më gjerë, si dhe në ofrimin e alternativave për zhgjidhjen e tyre. Përmes këtyre veprimeve, ata i zhvillojnë qëndrimet dhe vlerat, si: respektin, barazinë, tolerancën, gjykimin e drejtë, etj.

TEMA: DELIKUENCA E TË MITURVE

Kompetencat e synuara

Përmes kësaj teme synohet të arrihen elementet e kompetencave: *Komunikues efektiv, Mendimtar kreativ, Nxënës i suksesshëm, Kontribues produktiv, Individ i shëndoshë dhe Qytetar i përgjegjshëm.* Konkretisht, rezultatet: I. 2, 4, 8; II. 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8; III. 1, 3, 5, 7; IV. 1, 6, 7, 8; V. 6, 7; VI. 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8 të shkallës së katërt të Kurrikulës Bërthamë (shih KB e arsimit të mesëm të ulët, f. 19-22).

Qëllimi

Një e më shumë orë dhe aktivitete mësimore, dedikuar delikucencës, kanë për qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve për parandalimin e sjelljeve delikucente, si dhe të çdo elementi destruktiv a devijimi, që e dëmton zhvillimin fizik dhe intelektual të nxënësve.

Rezultatet e të nxënësve

Përmes trajtimit të kësaj teme, nxënësit:

- identifikojnë dhe analizojnë elementet e delikucencës;
- identifikojnë shkaqet dhe faktorët, që ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve delikucente;
- deshifrojnë rolin e tyre dhe të institucioneve relevante në parandalim dhe trajtim efikas të rasteve brenda dhe jashtë shkollës.

PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSVE

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi/ja duhet ta organizojë klasën, në mënyrë që të gjithë ta kenë vëmendjen gjatë shpjegimit të temës. Nuk ka rëndësi a ndahen nxënësit në grupe apo jo, pasi pjesa kryesore e orës realizohet në formë të ligjërimit nga ana e mësimdhënësit/es.

Për fillim, mësimdhënësi/ja përdor MINILEKSIONIN procedural dhe përmbajtësor. Kjo teknikë e mësimdhënies paraqet të gjitha procedurat e zhvillimit të orës mësimore me përmbajtjen dhe qëllimin e saj. Pak a shumë i ngjason mësimin tradicional, por kur fillon të zhvillohet teknika “*Stuhi mendimesh*”, atëherë ora merr zhvillim tjetër. Ndërkohë, mësimdhënësi/ja i vendos në mur të dhënat e siguruar, të cilat do t'i shërbejnë për realizimin e LEKSIONIT TË AVANSUAR.

Materialet e nevojshme:

Materialet e nevojshme për realizimin e orës mund të jenë:

- fletë, lapsa, tabelë shfletuese;
- statistika nga shërbimet policore;
- gjendje të ndryshme përshkruese shëndetësore (aludohet në përdorues të drogave);
- tiketa me elemente të delikucencës; etj.

Përveç materialeve, mësimdhënësi/ja mund të përgatisë edhe ndonjë material shtesë, si p.sh. një LEKSION TË AVANSUAR (kjo nënkupton se ka hulumtuar shumë lidhur me këtë temë dhe para nxënësve del me të dhëna të sakta.) Arsyeja pse mësimdhënësi/ja e merr vetë përsipër pothuajse gjithë shtjellimin e temës, është se këto tema janë të ndjeshme dhe mbase për nxënës janë “terrene” të panjohura.

Koha e nevojshme për zhvillim të temës

Një orë mësimore me mundësi vazhdimi.

ZHVILLIMI I TEMËS:

Aktiviteti mund ta filloni me shtrimin e pyetjeve, si p.sh:

- Çka kuptoni me nocionin delikuencë?
- A lind njeriu delikuent?
- A ndikojnë faktorët emocionalë, siç janë ndjenja e pasigurisë, mungesa e kujdesit prindëror, streset, ankthet?
- A e dëshirojmë ne, një gjendje të tillë?
- Si të shpëtohet nga kjo?

Kështu, realizohet pjesa hyrëse me teknikën “Stuhi mendimesh”. Pastaj, pas përgjigjeve të nxënësve, me anë të “LEKSIONIT TË AVANSUAR” (Ligjëratë), jepni informata të bollshme lidhur me definimin e qartë të delikuencës, prejardhjen e kësaj fjale, karakteristikat e delikuentit/tes (i cili/e cila shpesh gabon, bën faje, është individ jo stabil, nuk dëgjon, krijon shprehi të këqija, është kokëfortë, reflekton dhunë, fyen, e shpesh nuk është i vetëdijshëm për veprimet që i bën, ikën nga orët mësimore, nga shtëpia, humb dëshirën për të lexuar, ka mungesë koncentrimi, fillon të gënjejë, të vjedhë, të pijë duhan, alkool, dhe shpesh ka raste që përfundojnë si përdorues të substancave narkotike). Gjithashtu, u jepni informacionin nxënësve se moshat më të prira për këso sjellje janë ato 14-18 vjeçare. (Gjatë ligjëritimit mund t’i referoheni të dhënave, të cilat paraprakisht i keni vendosur në muret e klasës, e të cilat i keni siguruar më herët. Kurse, nxënësit mund të lëvizin t’i shohin këto të dhëna). Pas përfundimit të ligjëratës, nxënësit të cilët paraprakisht kanë marrë shënime në fletore, udhëzohen të punojnë në çifte dhe t’i përga-

tisin tri- katër situata, që paraqesin elemente të delikuencës, mbi bazën e këtyre tiketave (përmbajtja e tiketave mund të shkruhet në dërrasë të zezë ose paraprakisht të përgatitet nga mësimdhënësi, në formë të shiritave, dhe u shpërndahen secilit çift nga një), si p.sh.:

Tiketa 1: Nxënësi që shoqërohet me grupe huligane

Tiketa 2: Një nxënës çdo ditë vjedh gjëra të imta

Tiketa 3: Djali dhe vajza që përdorin substanca narkotike/psikoaktive

Tiketa 4: Ai dhe ajo ikin nga ora dhe i gënjejnë prindërit dhe mësimdhënësit e tyre

Tiketa 5: Ata po ngucen dhe po rrahen çdo ditë pas orëve mësimore

Këto pesë situata mund të përdoren asisoji, që nxënësit t’i japin idetë, se si duhet t’u ndihmohet nxënësve me sjellje delikente. Gjithashtu, me ndihmën tuaj, karshi secilës situatë, nxënësit ofrojnë zgjidhje të mundshme për të dalë nga problemet e supozuara, të cilat janë të ngjashme me rastet, që i njohin në realitetin jetësor.

Në fund fare, nxënësit e krijojnë tabelën në dërrasë të zezë (kompjuter të lidhur me projektor, nëse shkolla ka) në shtatë shtylla, ku për secilin rast i ofrojnë idetë e tyre, për rolet brenda familjes, shkollës dhe institucioneve të tjera, në identifikimin, e raportimin, referimin dhe trajtimin e tyre. Njëri nga nxënësit shënon, në tabelën e përgatitur, të dhënat (idetë) mbi bazën e diskutimeve.

Rastet sipas tiketave	Kush njoftohet fillimisht?	Cili është roli i familjes	Cili është roli i shkollës?	Cili është roli i nxënësve?	Ku raportohet rasti pas institucionit të shkollës dhe pse?	Cilat institucione të tjera janë përgjegjëse për trajtimin adekuat të këtyre rasteve?
Tiketa 1						
Tiketa 2						
Tiketa 3						
Tiketa 4						
Tiketa 5						

Krijimi i kësaj table, thëllon njohjen në këtë fushë, bën që nxënësit ta pozicionojnë veten si mbështetës të proceseve për identifikimin, raportimin dhe trajtimin e rasteve të delikuencës dhe t'i konsolidojnë idenë për përgjegjësitë e çdo institucioni, karshi problemeve sociale, që ndërlidhen me dukurinë e sjelljeve asociale/delikuencës.

Aktivitete shtesë

Një aktivitet shtesë në drejtim të parandalimit të delikuencës mund të jetë edhe vizita e organizuar e nxënësve në Qendrën për Punë Sociale (QPS), me ç'rast ata i vendosin kontaktet e bashkëpunimit me shërbimet sociale. Prej aty, ata e kuptojnë më qartë se QPS karshi rasteve dhe specifikave të tyre bëjnë ndërlidhjen e veprimeve me shërbimet e tjera qofshin ato shëndetësore, policore a korrektuese.

Gjithashtu, në nivel shkolle mund të organizohen debate më të mëdha, por edhe shfaqje teatrale dhe aktivitete të tjera artistike (orë letrare, ekspozita me punime, ese dhe pikturë, etj.), sipas zgjedhjes dhe interesimeve të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Përfundimi

Mësimdhënës të nderuar, temat dhe njësitë mësimore të paraqitura në këtë manual, nuk janë të vetmet që mund ta trajtojnë problematikën e dhunës, me gjithë kompleksitetin që ka ajo. Dhuna mund të shikohet dhe të analizohet nga perspektiva të shumta, pasi kërkohet qasje shumëdimensionale dhe kontribut ndërsektorial.

Për procesin e rregullt mësimor dhe orët mësimore, Ju mund të zgjedhni edhe tema të tjera sipas relevancës kontekstuale në shkollën dhe rrethin ku punoni. Gjithashtu, temat e tjera të larmishme mund t'i realizoni edhe në nivel të aktiviteteve ekstra-kurrikulare, si:

debate, aktivitete garuese, shfaqje teatrale, ekspozita me punime, etj.

Kësisoj, orët e rregullta mësimore dhe aktivitete shtesë, që mund t'i ketë shkolla me temën e dhunës, rrisin informacionin te grupmoshat e ndryshme të fëmijëve dhe ndikojnë në ndërtimin e qëndrimeve adekuate, karshi kësaj problematike. Një qasje e tillë e punës brenda shkollave promovon sigurinë dhe parandalimin e dhunës, si dhe favorizon ambientin për kultivimin e vlerave të qytetërimit demokratik.

Përkufizimet

Për qëllimet të këtij manuali dhe përdorimit nga mësime dhënësit, termat e mëposhtëm kanë kuptimin si në vijim:

Fëmijë - kuptohet çdo qenie njerëzore në moshën 18 vjeçare, me përjashtim të rasteve kur moshë madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin, të cilit ai i nënshtrohet.

Dhuna - nënkupton *“Të gjitha format fizike dhe/ose emocionale të keqtrajtimit, shpërdorimit seksual, neglizhencës ose trajtimit neglizhent, shfrytëzimit komercial ose çdo lloj shfrytëzimi, që ka si rezultat dëmtimin e mundshëm ose të vërtetë të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit a të dinjitetit të fëmijës, në kontekst të raportit të përgjegjësisë, besimit, ose forcës”*.

Dhuna - përfshin, por nuk kufizohet, në veprat ose veprimet e qëllimshme, që i bën një person personit tjetër, si: përdorimi i forcës fizike, presioni psikik, çdo veprim që shkakton ose kanos dhembje fizike dhe psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale, cenimit të dinjitetit; sulmi fizik, pa marrë parasysh pasojat; ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë; përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër; vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike.

Dhuna fizike - nënkupton çdo formë të abuzimit fizik, duke përfshirë këtu rrahjen me çfarëdo mjeti, goditje me shuplakë ose edhe me mjete të tjera, shtrëngimin e fytyrës dhe çdo veprim tjetër që shkakton dhimbje fizike.

Dhuna verbale - nënkupton përdorimin e fjalëve që shkaktojnë dëm për personin duke folur për të. Me dhunë verbale nënkuptohet: bërtitje, fyerje, kërcënim, frikësim, turpërim, poshtërim, përdorimi i gjuhës nënçmuese në mesin e formave të komunikimit. Dhuna verbale është edhe deklaratat negative për personin ose në lidhje me personin.

Keqtrajtim - konsiderohen të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimi seksual, neglizhimi ose trajtimi neglizhues a shfrytëzimi tregtar, ose çdo shfrytëzim tjetër që çon në dëmtim real ose të mundshëm të shëndetit të fëmijës, të mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit në kontekstin e një marrëdhënieje përgjegjësie, besimi ose pushteti.

Neglizhim - nënkuptohet mossigurimi nga prindërit ose kujdestari ligjor i kushteve për zhvillimin e fëmijës, kur prindi ose kujdestari ka mundësi ta bëjë këtë gjë: në drejtim të shëndetit, arsimit, zhvillimit emocional, ushqyerjes, strehimit dhe të kushteve të sigurta për jetesë, mbështetjen psikologjike, etj., të cilat çojnë në dëmtimin e mirëqenies fizike, psikike, morale e sociale të fëmijës.

Ngacmimi ndërmjet bashkëmoshatarëve - është sjellje agresive e padëshirueshme, në mesin e fëmijëve të moshës shkollë, që përfshin një mosbalancim real ose i perceptuar i pushtetit. Sjellja mund të përsëritet ose ka potencial të përsëritet, me kalimin e kohës.

Dhuna seksuale - nënkupton çdo akt seksual, çdo përpjekje për akt seksual, komentet ose përparimet e padëshirueshme seksuale,

aktet e trafikut, ose aktet që drejtohen ndaj seksualitetit të një personi me përdorimin e kërcënimit me ndëshkim, nga çdo person pavarësisht nga marrëdhënia e tij me viktimën, në çdo rrethanë, përfshirë këtu shtëpinë dhe punën, por pa u kufizuar këtu.

Abuzim seksual - përdoret shpesh për të treguar abuzimin brenda shtëpisë ose familjes, por ende nuk ekziston një marrëveshje reale për dallimin ndërmjet abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual.

Shfrytëzim seksual komercial - përdoret disa herë për të treguar prostitucionin femënor dhe pornografinë femënore.

Dhuna digjitale - nënkupton çfarëdo formë të dërgimit të porosive përmes internetit a telefonisë mobile. Ka për qëllim lëndimin, shqetësimin ose çfarëdo lloj tjetër të dëmtimit ndaj fëmijës, i cili nuk mund të mbrohet nga veprimet e tilla. Shfaqet në formë të videove ose porosive tekstuale, fotografive a thirrjeve.

Dhuna emocionale/psikologjike - përfshin mospërkrahimin e një mjedisi të përshtatshëm zhvillimor e mbështetës, përfshirë këtu mundësimin e një figure parësore për atashim me qëllim që fëmija të zhvillojë zotësi të qëndrueshme emocionale dhe sociale, në përshtatje me potencialin e tij personal, dhe në kontekstin e shoqërisë ku jeton. Ndaj fëmijës mund të kryhen akte, të cilat shkaktojnë ose kanë mundësi të madhe të shkaktojnë dëm në shëndetin ose në zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social. Këto akte mund të jenë në kontrollin e prindit ose të një personi, i cili ka përgjegjësi, është i besuar ose ka pushtet. Akte të tilla përfshijnë kufizimin e lëvizjeve, talljen, denigrimin, fajësimin, kërcënimin, trembjen,



diskriminimin, përqeshjen, ose forma të tjera jofizike të armiqësisë ose të trajtimit refuzues.


**MATERIALET
QË MUND TË
PËRDOREN PËR
REALIZIMIN
E TEMAVE
MËSIMORE**



Klasa I -Aktiviteti “Rregullat ‘Pizza’”


Fusha e Kurrikulës: Shëndeti dhe mirëenja








Fusha e Kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi





Faleminderit!



Më fal!

Ju lutem!


Mirupafshim!





Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi



Fusha e Kurrikulës: Jeta dhe puna





Klasa II

Ngrita zërin

Epo, shumë jam mërzitur
me ç`po ndodh
në shtëpi.
Ta tregoj, sa për ta ditur
pastaj,
ja më thuaj ti:

M`i blen mami
tërë fustanet,
bishtalecat m`i thur gjyshja,
në shtëpi
më hidhet babi:
“Ja na erdhi dallëndyshja”.

Gjyshi nuk di tjetër punë:
“Mos këtu e mos atje.”
“Në shkollë sot!?”
“Oh, e çoj unë.
Vetëm çupën nuk e le!”

Por një ditë kërkova mbledhje,
reth tryezës,
në shtëpi,
të ngre zërin,
të bëj zgjedhje,
të vë pikat përmbi i:

“Ç`është kështu me ju zotërinj?
Mos si lodër ju jam dukur?
Unë jam vajzë,
jam fëmijë,
nuk jam zog,
e nuk jam kukull.
Nuk i dua bishtalecat
dhe fustanet
i zgjedh vetë.
Mos më thoni dallëndyshe,
por me emrin e vërtetë.

Unë kam emër shumë të buku,
pa kam fjalë
e kam mendime,
kam inatë dhe dëshira,
kam edhe të drejtën time!”

Ja kështu,
Qerpikpadridhur
i rendita fjalët vetë.
Se...harrojnë që jam rritur,
jam,
ohuuuu,
në klasë të dytë!

(N. Porocani)



Klasa III

Tiketatat me situata problemore

Tiketa 1: Një nxënës godet me grusht një nxënës tjetër

Tiketa 2: Një prind i thotë vazhdimisht fëmijës së vet “budalla dhe i pavlerë”

Tiketa 3: Shokët asnjëherë nuk e pranojnë në lojë një fëmijë

Tiketa 4: Një grup nxënësish përqeshin shokun, shoqen ose një grup të nxënësve të tjerë.

Letra e Erës

Unë dua të të tregojë një ngjarje që më ka ndodhur dy ditë më parë. Po luaja në shtëpi me vëllanë tim. U fsheha prapa bibliotekës. Atje ishte një vazo e madhe. Babi më pa dhe më bërtiti: “Kujdes, mos ta thyesh vazon!”

Më vonë, unë dola që andej, por vazoja ra dhe u thye. Babi u nxeh dhe më shau shumë. Ka dy ditë që babi nuk më flet. Mami më tha që vazoja ishte shumë e çmuar. Babi e kishte kujtim nga gjyshi i tij.

Kjo më mërziti edhe më shumë. Ju lutem, më thoni diçka për këtë. Unë ndihem shumë keq.



Klasa V

Organizuesi alfabetik

A	B	C	Ç	D	DH
E	Ë	F	G	GJ	H
I	J	K	L	LL	M
N	NJ	O	P	Q	R
RR	S	SH	T	TH	U
V	X	XH	Y	Z	ZH



Rregullat për zgjidhjen e konflikteve

- Dëgjoje dhe palën tjetër ç'thotë!
- Mos i sulmo njerëzit, por shqyrto problemin!
- Fyerja nuk ndihmon!
- Ke përgjegjësi për veprimet e tua!
- Çka ishte kaloi - me rëndësi është çka do të bëhet!



Fletë me situata konfliktuozë



1. Era dhe nëna

- a. Era: Nënë ma jep çokollatën!
- b. Nëna: Nuk hahet çokollata para darkës
- c. Era: Ti vetëm tim vëllai ia jep menjëherë kur e kërkon!!!
(shembull situata në fjalë lidhet me rregullën “Dëgjoje edhe palën tjetër ç'thotë”)




2. Ariani dhe Vesa

- a. Era: Nënë ma jep çokollatën!
- b. Nëna: Nuk hahet çokollata para darkës
- c. Era: Ti vetëm tim vëllai ia jep menjëherë kur e kërkon!!!
(shembull situata në fjalë lidhet me rregullën “Dëgjoje edhe palën tjetër ç'thotë”)



3. Babi dhe Artani

- a. Babai: Pse nuk e vendose çantën në vendin e vet?
- b. Artani: Mua çdo herë më qorton, kurse Anës (motrës) një fjalë nuk ia thua!
- c. (Shembull situata në fjalë lidhet me rregullën “Ke përgjegjësi për veprimet e tua”)



4. Hana dhe Eni

- a. Hana: Pa shihe, shihe! Edhe kjo torrollakja po ditka diçka!
- b. Eni: Në qofsha unë torrollake, atëherë ti çka je?
- c. Hana: Njëqind herë jam më e mirë se ti!
- d. (Shembull situata në fjalë lidhet me rregullën “ Fyerja nuk ndihmon”)



5. Dielli dhe Ernesti

- Dielli: Si e hëngre gjitha ëmbëlsirën duke e ditur se edhe mua më pëlqen?
Ernesti: Ç'faj kam unë që ti nuk ishe në shtëpi!
Dielli: Ti je vetjak!
(Shembull situata në fjalë lidhet me rregullën “Mos i sulmo njerëzit, por shqyrto problemin”)

Klasa IX

Tiketa me element të delikuencës



Tiketa 1: Nxënësi që shoqërohet me grupe huligane



Tiketa 2: Një nxënës çdo ditë vjedh gjëra të imta



Tiketa 3: Djali dhe vajza që përdorin substanca narkotike/psikoaktive



Tiketa 4: Ai dhe ajo ikin nga ora dhe i gënjejnë prindërit dhe mësuesin e tyre



Tiketa 5: Ata po ngucen dhe po rrahen, çdo ditë pas orëve mësimore

IKEA Foundation



Ky manual u hartua dhe u botua me përkrahjen e Fondacionit IKEA

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

316.485.26-055.2)(035)

Manual didaktik për parandalimin e dhunës / Aliriza
Arenliu ...[et al.]. – Prishtinë : Save the Children, 2014.
– 80 f. ; 21 cm.

I. Arenliu, Aliriza

ISBN 978-9951-534-26-0